



RAPPORT VJETOR 2008

Përgatiti në shqip

Jorida Cila

Përkthyer në anglisht

Darina Kokona

Korrektimi letrar në shqip

Olta Çakçiri

Korrektimi letrar në anglisht

Benjamin White

Dizenjimi

CreoStudio



Shtypur në

Shtëpia Botuese Afrojdit




botime afrojdit



Përmbajtja

- 07 **Fjala përshëndetëse e Drejtorit Ekzekutiv**
- 08 **Ngjarjet kryesore të vitit**
- 24 **Drejtuesit dhe Stafi i Co-PLAN**
- 30 **Fushat e ekspertizës së Co-PLAN**
- 32 **Transparenca e Co-PLAN**
- 38 **Projektet & Programet 2008**



UNIVER



SITETI POLIS



Përshëndetje të nderuar miq

Si çdo vit, Co-PLAN vjen pranë jush me një raport përmbledhës të punës dhe arritjeve të veta vjetore. Edhe për vitin 2008, ky raport paraqet aktivitetet dhe projektet e zbatuara nga organizata si edhe evenimentet kyç përgjatë këtij viti.

Në nivel organizate, viti 2008 ka shënuar disa ndryshime të rëndësishme si: profilizimin e organizatës në fushën e ndikimit të politikave publike; forcimin e lidhjeve institucionale të organizatës me Universitetin POLIS; thellimin e ekspertizës përtej planifikimit urban, ku mund të veçojmë menaxhimin financiar bashkiak apo edhe kërkimet dhe hulumtimet shkencore; hartimin e dokumenteve të politikave për fusha të rëndësishme si menaxhimi i pronave dhe aseteve, zhvillimi rajonal dhe menaxhimi i mbeturinave. Po ashtu, viti që sapo kemi lënë pas ka qenë i ngarkuar edhe me vështirësi të ndryshme për shkak të ndryshimit të politikave të mbështetjes nga komuniteti ndërkombëtar dhe ndryshimit në modelin e ndihmës së huaj të ardhur në Shqipëri. Por, pavarësisht vështirësive, këto sfida janë pritur dhe menaxhuar me efikasitet si nga strukturat drejtuese ashtu edhe nga vetë stafi i organizatës, duke e sjellë atë në vitin 2009 të gatshme për t'u përballur me sfida të reja.

Për t'u njohur më nga afër me punën tonë, ju ftoj të shfletoni Raportin tonë Vjetor. Ju uroj lexim të këndshëm!

Dritan Shutina
Drejtore Ekzekutive




Ngjarjet kryesore të vitit

Co-PLAN si një Institut Kërkimor Shkencor

Duke nisur nga viti 2008, Co-PLAN është bërë pjesë e Universitetit Polis, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave Urbane. Kjo marrëdhënie është institucionalizuar përmes një marrëveshjeje partneriteti të nënshkruar midis Co-PLAN & U-Polis në 1 Tetor 2007. Co-PLAN përbën një nga shtyllat kryesore të Institutit Kërkimor Shkencor, i cili në vetvete është i përbërë nga katër institucione, duke garantuar punën kërkimore dhe aplikative për U-Polis.

Për Co-PLAN, ky është një evolucion qoftë i formës e strukturës ashtu edhe i qëllimit dhe rrezes së ndikimit të vet, që e sheh këtë organizatë të shndërrohet gjatë këtyre trembëdhjetë vjetëve nga një organizatë zhvillimi në një institut kërkimor shkencor. Në fakt, angazhimi i Co-PLAN në forma të ndryshme të kërkimit shkencor ka filluar bashkë me fillimin organizatës, kur Co-PLAN përdorte një sërë instrumentesh për të analizuar zhvillimet e vullshme urbane në vend, e kryesisht në Tiranë. Më pas, Co-PLAN e ka shtrirë eksperiencën e vet edhe në ofrimin e një sërë shërbimesh konsulente si për shembull vlerësime social-ekonomike, vlerësime të impaktit, vlerësim projektesh, vlerësime organizative, analiza politikash etj. Sigurisht që planifikimi dhe zhvillimi urban, dhe së fundmi ai rajonal, menaxhimi mjedisor dhe financat lokale, krahas zhvillimit institucional dhe organizativ, do të mbeten komponentë kryesorë për Co-PLAN edhe në aspektin e kërkimit shkencor. Në këtë kuadër vlen të përmendet edhe çmimi i Ekselencës Shqiptare që iu dha Co-PLAN në vitin 2007 pikërisht për kontributin e dhënë në kërkimin shkencor në fushën e zhvillimit urban dhe atij rajonal.

Të qenët pjesë e një institucioni arsimor sjell përfitime të dyanshme. Për Co-PLAN ky zhvillim do të thotë një hap përtej mundësive që më parë ofroheshin nga projekte të ndryshme duke i hapur rrugën edhe rritjes cilësore të profilit kërkimor brenda organizatës. Për U-Polis kjo përkthehet në një lidhje organike mes mësimdhënies dhe anës aplikative të shumë çështjeve thelbësore në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm. Një nga frytet e këtij bashkëpunimi pritet të jetë edhe një forcim i lidhjes mes kërkimit shkencor dhe botimeve akademike, duke kontribuar kështu edhe në gjenerimin dhe përhapjen e njohurive tek brezat e rinj si edhe tek studiues të ndryshëm.



Axhenda Mjedisore në Co-PLAN

Co-PLAN, i udhëhequr nga filozofia e mbrojtjes së mjedisit si kusht për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, mbetet i përkushtuar në përpjekjet dhe kontributin e tij për të adresuar problematika mjedisore në nivel lokal dhe rajonal përmes projekteve, kërkimeve dhe studimeve të mëtejshme në këtë fushë.

MANAXHIMI I MJEDISIT NË NIVEL VENDOR

MANAXHIMI
I MBETJEVE TË
NGURTA



ENERGJIA E
QËNDRUESHME



TRANSPORT I
QËNDRUESHËM



VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Në këtë vit, Co-PLAN ka ndërmarrë një numër të konsiderueshëm projektsh, si në nivelin vendor ashtu dhe atë rajonal, të fokusuara në fushën e mjedisit. Megjithatë, për të artikuluar dhe konsoliduar më tej profilin e tij mjedisor, Co-PLAN e ka kthyer atë në një nga shtyllat kryesore të punës së tij krahas zhvillimit urban/rajonat, financave lokale, zhvillimit organizativ dhe institucional dhe ndikimit të politikëbërjes.

Në këtë këndvështrim, Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta, Energjia e Qëndrueshme dhe Transporti si komponentë kryesorë të Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis si një komponent i ndërthurur, përbëjnë profilin mjedisor të Co-PLAN

Në këtë kontekst, edhe viti 2008 ka ravigjësuar angazhimin tonë të vazhduar në aktivitete të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

Mbrojtja e Mjedisit dhe Promovimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në kuadër të programit “Ndikimi i Politikëbërjes”, Co-PLAN, mbështetur nga Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI), në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Platformën IDR (Instituti për Reforma dhe Demokraci), kjo e fundit mbështetur nga Fondacioni Hanns Seidel, organizoi seminarin kombëtar me temë “Mbrojtja e Mjedisit dhe Promovimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm”. Takimi në nivel ekspertësh u ndoq nga përfaqësues të MMPAU, profesionistë të ndryshëm që punojnë mbi çështje të planifikimit mjedisor vendor dhe rajonal, institucione kërkimore dhe shkencore si dhe përfaqësues të qeverisjes vendore, organizatave mjedisore dhe komunitetit të biznesit, medias dhe shoqërisë civile.

Kjo konferencë shtroi debatin mbi arritjet dhe mundësitë, si të vendit ashtu edhe të qeverisë, lidhur me mjedisin. Co-PLAN kontribuoi me një nga 2 ekspertët që drejtuan seminarin me një prezantim të politikave mbi trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane, duke nënvizuar ndikimin e tyre në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve, teknologjinë e përshtatshme lidhur me trajtimin e depozitimin dhe kostot e tyre përkatëse si edhe shkallën e përshtatshme territoriale të menaxhimit të shërbimit.

Çështje të standardeve të shërbimit u ngritën gjithashtu në takim nga Co-PLAN.



Studimi mbi Eficiencën e Përdorimit të Energjisë në Banesa

Në shkurt 2008 u realizua, në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës, studimi mbi përdorimin me eficiencë të energjisë në banesa dhe gjetjet kryesore si dhe rekomandimet e nxjerra nga ky studim u prezantuan në një tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë.

Ndërkohë që Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e asistuar nga IFC, kishte ndërmarrë iniciativën për hartimin dhe miratimin e ligjit për “Bashkëpronësinë e detyrueshme në ndërtesa”, Co-PLAN, nëpërmjet kësaj tryeze, duke prezantuar gjetjet e studimit të fundit mbi “Konsumin e energjisë në banesë dhe aspekte të mirëmbajtjes së tyre për rajonin e Tiranës”, synoi t’i jepte një tjetër dimension të munguar ligjit, atë të perceptimit të banorëve mbi mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të banimit.

Duke qenë se ligji është vetëm njëra anë e procesit dhe nuk mund të garantojë zgjidhjen e problemit që ka sot sektori i strehimit në këtë drejtim, një rëndësi të madhe, në mënyrë që ky ligj të mos mbetet thjesht një ligj më tepër, ka edhe informimi mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë palët si dhe vlerësimi i kapaciteteve që ekzistojnë.

Konkluzioni kryesor i kësaj tryeze ishte se iniciativat e përdorimit me eficiencë të energjisë në banesë, jo vetëm që do të kontribuojnë në mënyrë të qenësishme në mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta të banimit por, në të njëjtën kohë, do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së banorëve, duke u dhënë atyre edhe përfitime konkrete.




Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Ndërtesave të Larta të Banimit për Vendet në Tranzicion

Në kuadër të ngritjes së mëtejshme të kapaciteteve dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në Shqipëri drejt një kontributi më të arrirë në fushën e mjedisit dhe në zhvillimin e mëtejshëm urban të vendit, Co-PLAN dhe IHS (Instituti për Strehim dhe Studime në Zhvillimin Urban organizuan, në bashkëpunim, një kurs 2-javor në Holandë, me mbështetjen e Ministrisë së Strehimit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Holandës. Tema e kursit ishte: “Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Ndërtesave të Larta të Banimit për Vendet në Tranzicion”.



Ky aktivitet u ndoq nga përfaqësues të Co-PLAN, Universitetit Polis, bashkisë Fier, bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet shkëmbyen eksperiencat dhe idetë e tyre lidhur me instrumentet e menaxhimit për mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit duke u bazuar në eksperiencat të ngjashme të vendeve të tjera në tranzicion. Modelet e fituara gjatë këtij kursi do të gjejnë zbatim në Shqipëri duke rritur efikasitetin në ofrimin e alternativave më të mira gjatë adresimit të çështjes në fjalë.



Përtej Strategjive

Transformimet e mëdha me të cilat u përball vendi ynë pas viteve '90 në sferën ekonomike, politike, shoqërore, mjedisore etj. janë përkthyer në ndryshime rrënjësore në territorin urban e atë rural dhe paraqesin sfida të forta për zhvillimin e qëndrueshëm. Këto procese kanë ecur paralelisht me atë të decentralizimit, proces i cili tashmë po përmbush fazën e delegimit të kompetencave dhe ka hyrë në atë të konsolidimit. Të gjitha këto zhvillime kërkojnë që njësitë e qeverisjes vendore të fuqizojnë rolin e tyre në administrimin e territorit dhe të promovojnë zhvillimin ekonomik. Teksa baza ligjore është pothuajse e plotësuar, sfida e madhe e pushtetit vendor qëndron në krijimin e hapësirave dhe zhvillimin e instrumenteve për të rritur burimet e financimit në nivel vendor.




Në përgjigje të këtyre problematikave komplekse, shumë pushtete vendore kanë hartuar dhe po hartojnë strategji zhvillimi. Megjithatë, zbatimi i këtyre strategjive në funksion të zhvillimit ekonomik lokal kërkon investime të mëdha kapitale, të cilat kalojnë përtej mundësive aktuale të pushteteve vendore. Nevoja për zhvillim ekonomik kërkon shërbime urbane të konsoliduara për të tërhequr biznesin, ndërkohë që mungesa e një ekonomie të qëndrueshme çon në gjenerimin e më pak të ardhurave për investime. Sfida e pushteteve vendore është thyerja e këtij rrethi vicioz përmes adoptimit të instrumenteve bashkëkohore që çojnë në mirëmenaxhimin e të ardhurave vendore, krahas ripozicionimit të pushtetit vendor si udhëheqës i transformimeve urbane. Këto ishin edhe çështjet thelbësore të cilat Co-PLAN i trajtoi në Forumin Urban Kombëtar “Përtej Strategjive - Si të lidhim menaxhimin financiar me atë urban në nivel vendor?!” të organizuar në muajin Nëntor 2008.



Përtej Decentralizimit

Zhvillimi rajonal është një tematikë e cila vetëm kohët e fundit ka filluar të tërheqë vëmendjen e autoriteteve qendrore si edhe atë të ekspertëve dhe studiuesve të ndryshëm në vendin tonë. Kjo edhe për faktin se në mbarë botën, e kryesisht në Evropë, ngritja e rajoneve ekonomike apo edhe e rajoneve të shërbimit është një tendencë e dekadave të fundit. Në kuadër të aspiratave dhe reformave të zbatuara nga Qeveria Shqiptare me qëllim integrimin Evropian të vendit, trajtimi i çështjes së zhvillimit rajonal kthehet në një domosdoshmëri.

Në aspektin e analizave të politikave dhe në atë të kërkimit shkencor Co-PLAN ka nisur, prej rreth dy vitesh, hulumtimet mbi mundësitë e organizimit të reformës territoriale në vend dhe rajonalizimit të Shqipërisë. Edhe tryeza e fundvitit e titulluar “Përtej Decentralizimit - Rajonalizimi i Shqipërisë dhe efektet e tij në organizimin territorial” synonte të tërhiqte vëmendjen e aktorëve të ndryshëm, e kryesisht atyre qeveritarë, mbi nevojën e vendit për të adoptuar një reformë territoriale si edhe të paraqiste skenarë të ndryshëm zhvillimi bazuar në organizime të ndryshme territoriale të vendit në funksion të zhvillimit rajonal. Co-PLAN ka përgatitur edhe një dokument politikash të titulluar “Rajonalizimi i Shqipërisë përkundrejt riorganizimit territorial”, dokument i cili u është dërguar Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Ministrive të linjës si edhe shumë aktorëve të tjerë të cilët punojnë me çështjet e zhvillimit rajonal dhe reformës territoriale. Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive rajonale shumë shpejt do të kthehet në prioritet të Qeverisë Shqiptare si një nga mënyrat më të mira për të përafuar vendin me strukturat ekzistuese të BE.



Vizita e IIUD (Instituti Ndërkombëtar për Zhvillimin Urban) në Shqipëri

Për të rritur ndërveprimin e tij me U-Polis si dhe për të ballafaquar më tej eksperiencën e tij me eksperiencën të organizatave partnere, Co-PLAN mundësoi një vizitë pune në Shqipëri të bordit të IIUD, institut që ka mbledhur akademikë dhe profesionistë themelues të Qendrës për Kërkime Urbane pranë Universitetit të Harvardit.

Stafi i këtij instituti ka qenë i përfshirë që prej vitit 1996 në çështjet që prekin zhvillimin urban në Shqipëri, duke ndihmuar në lançimin dhe si rrjedhojë edhe në koordinimin e asistencës së dhënë nga Banka Botërore dhe USAID deri në përfundimin e Programit për Menaxhimin e Tokës Urbane.

Prej më se 10 vjetësh, instituti bashkëpunon në vazhdimësi me Co-PLAN duke u fokusuar në projektet kërkimore të cilat përfshijnë edhe një kumtesë, e cila u prezantua në Simpoziumin për Kërkime Urbane të Bankës Botërore, mbi çështjet e përdorimit dhe tregut të tokës në vitin 2008.

Për çdo vit, IIUD thërret mbledhjen e bordit në një nga vendet ku instituti dhe stafi i tij janë të angazhuar. Përgjatë tetorit 2008, bordi i IIUD udhëtoi drejt Shqipërisë ku u organizua edhe një vizitë në bashkëpunim me Co-PLAN.

Kjo vizitë përfshiu shkëmbimin e eksperiencave mes dy organizatave si edhe vizita në terren, aty ku janë zbatuar projektet e zhvillimit urban, si në Tiranë, Bathore, Durrës, Shkodër dhe Berat. Roger Kallman, Ted Raymond dhe Clemens Sels prezantuan disa prej projekteve të tyre të tanishme në një nga forumet e përjavshme urbane që organizohen në Universitetin Polis.

Anëtarët e stafit dhe bordit të IIUD-së zhvilluan gjithashtu takime me Kryeministrin e Shqipërisë dhe me Kryetarët e bashkive Tiranë dhe Fier.



Co-PLAN dhe Partnerët e tij

Përpjekjet tona në vite për të dhënë një kontribut të vazhdueshëm për zhvillimin e vendit janë mundësuar falë mbështetjes së rëndësishme të partnerëve tanë strategjikë. Bashkëpunimi dhe partneriteti i ndërtuar përgjatë 13 viteve të eksperiencës sonë ka udhëhequr drejt zbatimit të suksesshëm të modeleve dhe praktikave të cilat kanë ndikuar në fuqizimin e mëtejshëm të komunitetit në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Si për çdo vit, ne dëshirojmë të theksojmë falënderimin tonë për Cordaid, Ambasadën e Mbretërisë së Holandës, Institutin për Strehim dhe Studime në Zhvillimin Urban (I.H.S.), OSI/ OSFA si edhe partneritetet e mundësuar me agjenci zhvillimi si Komisioni Evropian, Banka Botërore, PNUD, ADA, USAID, SDC (Agjencia Zvicerane për Zhvillim), REC (Qendra Rajonale e Mjedisit) etj.

Seria e Botimeve

“Midis Vakumit dhe Energjisë!” është një libër që përpiket të strukturojë dhe dokumentojë tri faza të rëndësishme të zhvillimit të praktikave dhe filozofisë së planifikimit dhe qeverisjes urbane në Shqipëri, përmes eksperiencës së Co-PLAN dhe partnerëve të tij në Shqipëri dhe jashtë saj. Në këtë libër parashtrohet filozofia e Co-PLAN që e shikon planifikimin urban jo si një çështje të thjeshtë teknike, por mbi të gjitha si një përpjekje për të përmirësuar skeletin e shoqërisë; për t’u adoptuar ndaj ndryshimeve të statuskuosë ndërsa vetë shoqëria ndryshon dhe evoluon. Një vend të veçantë në këtë libër zë eksperiencia e Co-PLAN në kuadër të Programit “Drejt një Qeverisjeje të mirë Urbane” që u bë edhe shkaku për realizimin e këtij libri.



Manuali për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale: realizimi i këtij Manuali u mundësua nëpërmjet disa projekteve me të cilat Co-PLAN është angazhuar përgjatë vitit 2008, të cilat fokusoheshin në fushën e menaxhimit financiar në nivel vendor. Manuali është hartuar bazuar në eksperiencat dhe modelet e ngjashme në botë dhe në bashkëpunim me tri Bashki të ndryshme në vend. Ky manual shërben si një udhërrëfyes për pushtetin vendor në Shqipëri. Ai e ndihmon pushtetin vendor të përmirësojë mënyrat e planifikimit duke vënë theksin e duhur në lidhjen e investimeve të parashikuara në strategjitë e zhvillimit dhe planet rregulluese me burimet financiare të nevojshme për zbatimin e tyre.



Planet Strategjike të Zhvillimit: Koplik, V. i Dejës, Pukë, F. Arrëz, Dajç, Gur i Zi. Në kuadër të programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor, të financuar nga SDC përmes Intercoperation, Co-PLAN, në bashkëpunim me administratat vendore përkatëse, ka asistuar në përgatitjen dhe botimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit për gjashtë njësi vendore në Qarkun e Shkodrës, përfituese të këtij programi. Këto Strategji përmbajnë një analizë të detajuar të situatës aktuale si edhe vizionin e zhvillimit të shoqëruar me një plan afatmesëm veprimi me qëllim realizimin e këtij vizioni si edhe me një analizë të ndikimit të këtyre zhvillimeve në territor.



Programi i Zhvillimit për Zonën Pilot në Bashkinë e Elbasanit: ky është një dokument i bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit dhe në Strategjinë Kombëtare për Romët dhe përqendrohet në lagjen “5 Maji” e cila ka edhe popullsinë më të madhe Rome në qytet. Dokumenti paraqet një model të zhvillimit të lagjes që synon integrimin e kësaj lagjeje me pjesën tjetër të qytetit.



Lidershipi Shqiptar 2008

Viti 2008 shënoi pesë-vjetorin e Lidershipit Shqiptar, një çmim i cili filloi si një aktivitet prestigjioz brenda një prej projekteve të zbatuara nga Co-PLAN por që, me kalimin e viteve, u shndërrua në një aktivitet mbarëshqiptar. Për çdo vit, janë katër çmime që jepen nga Komiteti i Lidershipit Shqiptar i cili është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidaturave, përkatësisht për fushat: Qeverisje, Media, Sektor Privat dhe Shoqëri Civile.

Komiteti i Lidershipit Shqiptar është një strukturë anëtarët e së cilës janë figura të spikatura në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore në vend. Për vitin 2008, anëtarët e këtij komiteti ishin:

Besnik Aliaj (Rektor i Universitetit Polis); Ermelinda Meksi (Deputete në Parlamentin Shqiptar); Gazmend Oketa (Ministër i Mbrojtjes); Ilir Zhilla (Kryetar, Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë); Sokol Balla (Drejtor i Departamentit të Lajmeve, Top Channel); Sotir Dhamo (Anëtar i Bordit Drejtues të Co-PLAN); Valdet Sala (Drejtuese e Projektit të Shoqërisë Civile, GTZ)

Çmimet e Lidershipit Shqiptar për vitin 2008:

Shoqëria Civile: Altin Hazizaj

CRCA Qendra e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri

CRCA ka dhënë një kontribut të prekshëm dhe me rëndësi në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut në tërësi, duke e çuar ndikimin e vet deri në sferën e politikëbërjes nëpërmjet kontributit të dhënë në hartimin e legjislacionit përkatës.

Media: Adi Krasta

Adi Krasta është një gazetar që gjithmonë ka ditur të përcjellë vlera te njerëzit. Ka ruajtur në vazhdimësi një nivel të lartë profesional dhe intelektual të programeve që ka drejtuar dhe ka rrezatuar energji pozitive sociale duke krijuar mundësi ekspozimi dhe shprehjeje për njerëzit e thjeshtë, talentet dhe të rinjtë, përmes projekteve televizive dhe atyre radiofonike.

Sektori Privat: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës

Falë një pune të shkëlqyer, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është bërë një nga partneritetet publike-private më të suksesshme në vend, duke krijuar standarde shërbimi dhe menaxhimi të nivelit evropian. Përtej ndikimit në ekonominë e vendit, Aeroporti i Tiranës ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në ndryshimin e imazhit të Shqipërisë, veçanërisht në sytë e vizitorëve e turistëve të huaj, si një vend dinamik, i hapur dhe i qëndrueshëm për investimet vendase dhe të huaja.



Qeverisje: **Posta Shqiptare**

Posta Shqiptare është një nga institucionet publike që ka ndërmarrë me sukses reforma të thella për përmirësimin dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve ndaj komunitetit si dhe për ndryshimin e imazhit të këtij institucioni tek qytetarët. Institucioni i Postës Shqiptare tashmë është njohur edhe nga një numër organizmash ndërkombëtare të cilat kanë vlerësuar arritjet e Postës Shqiptare në drejtim të ofrimit të shërbimeve të nivelit evropian.

Çmimi special: Në vitin e pestë të tij, **Lidershipi Shqiptar** caktoi një çmim special për **Z. Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.**

Dr. Fatmir Sejdiu është një prej personaliteteve që kanë dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm për mendimin dhe aksionin politik modern në Kosovë dhe Ballkan dhe, në mënyrë të veçantë, për lirinë e pavarësinë e Republikës së Kosovës si shtëpia e të gjithë atyre që besojnë tek demokracia, të drejtat e njeriut dhe harmonia e popujve. Sejdiu ka arritur që, përmes modelit të Presidencës së tij, të shndërrohet në “Ambasadorin e Paqes” për Kosovën dhe në figurën kryesore konsensuale e gjithëpërfshirëse, si në debatet politike dhe sociale brenda Kosovës ashtu edhe në raportet e ballafaqimit me institucionet ndërkombëtare. Për këtë arsye, ai vazhdon të mbetet jo vetëm lideri dhe politikani më i spikatur në Kosovë, por edhe një nga figurat politike më të pëlqyera dhe negociatorët më të respektuar në mbarë hapësirën shqipfolëse dhe më gjerë në rajon.









Drejtuesit dhe Stafi i Co-PLAN

Co-PLAN është një organizatë e strukturuar në mënyrë horizontale, pra një organizatë me një nivel minimal hierarkie në organigramën e saj. Organizata drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i cili konsultohet në mënyrë sistematike me Bordin Drejtues të organizatës si edhe me Bordin Këshillimor. Këto struktura e ndihmojnë organizatën të pozicionohet në mënyrë strategjike në kuadër të zhvillimeve të ndryshme në vend apo edhe të ndryshimeve në arenën ndërkombëtare të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ecurinë e organizatës. Ekspertët e Co-PLAN janë ata të cilët përbëjnë thelbin e organizatës dhe ata të cilët garantojnë mbarëvajtjen e projekteve dhe arritjen e rezultateve pozitive duke mbrojtur emrin dhe profesionalizmin që Co-PLAN ka fituar në këto 13 vite të ekzistencës së vet.





Bordi Drejtues



Sokol Çelo
Drejtor i
Bordit Drejtues

Sokol Çelo po kryen studimet e doktoraturës për Biznes Ndërkombëtar në “Florida International University” duke u specializuar në këndvështrimin institucional të investimeve të huaja në vendet ish-komuniste dhe ato në transicion. Më parë është diplomuar si matematikan në Universitetin e Tiranës dhe më tej ka përfunduar programin Master në Administrim Biznesi të ofruar nga Universiteti i Tiranës dhe ai i Nebraskës. Ai e filloi karrierën e tij profesionale në fushën akademike si pedagog i matematikës në Universitetin e Tiranës dhe vazhdoi më tej në fushën e projekteve zhvillimore duke punuar si menaxher projekti për GTZ dhe më vonë për PNUD. Është anëtar dhe Kryetar i Bordit Drejtues të Co-Plan që prej vitit 2002.



Besnik Aliaj
Anëtar

Diplomuar në Arkitekturë-Urbanistikë nga Universiteti i Tiranës. Më pas ka marrë titullin Master në Zhvillim dhe Menaxhim Urban nga IHS-Rotterdam dhe Universiteti Erasmus, Holandë. Në vitin 2007 mbron titullin “Doktor i Shkencave” në Universitetin Politeknik të Tiranës. Pas dy viteve eksperiencë pune në qeverisjen vendore, zotëron 17 vjet eksperiencë akademike pranë Universitetit Politeknik, Akademisë së Arteve të Bukura, Universitetit “Polis” në Tiranë dhe Universitetit Teknik të Darmstadt, Gjermani. Eksperiencë 10-vjeçare me shoqërinë civile. Bashkëthemelues dhe ish-drejtues i Co-PLAN; ish-Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë; bashkëthemelues i Platforma-IDR, Instituti për Demokraci e Reforma. Këshilltar i Kryeministrit për planifikimin dhe menaxhimin e territorit në periudhën 2005/7. Bashkëthemelues dhe Rektor i Universitetit “Polis” dhe autor i disa botimeve profesionale. Ka fituar çmimin “Fisnikëria Tiranase” në vitin 2004 dhe çmimin “Qytetar Nderi i Kamzës” në vitin 2006.



Sotir Dharmo
Anëtar

Diplomuar si Planifikues Urban nga Universiteti i Tiranës; më pas fiton titullin Master në Administrim Publik nga Universiteti i Sirakuzës, ShBA. Ka ndjekur programe të ndryshme pasuniversitare në disa vende të Evropës. Eksperiencë e gjatë në mësimdhënie, si në universitetin publik ashtu edhe në atë privat. Një nga bashkëthemeluesit e Universitetit POLIS, ku aktualisht kryen funksionin e Administratorit të Përgjithshëm, pa lënë pas dore edhe mësimdhënien. Autor i disa artikujve të botuar në gazeta dhe revista lokale apo të prezantuar në aktivitete ndërkombëtare. Eksperiencë e gjatë pune në administratën publike si edhe në shoqërinë civile, me fokus në hartim dhe zbatim projektsh, hartime planesh rregulluese si edhe në zhvillim institucional dhe forcim organizativ. Ka punuar pranë Co-PLAN për rreth 5 vjet, ku edhe ka qenë anëtar i Bordit Ekzekutiv të organizatës.

Bordi Këshillimor



Ferry van Wilgenburg ka një eksperiencë të gjatë ndërkombëtare në fushën e menaxhimit urban dhe strehimit, në veçanti në vendet Aziatike dhe ato të Evropës perëndimore dhe lindore. Aktivitetet e tij ndërkombëtare janë fokusuar në ngritje dhe forcim kapacitetsh, trajnime dhe shërbime konsulence. Gjatë nëntë viteve të fundit ai ka punuar kryesisht në Holandë. Në Bashkinë e qytetit të Rotterdemit ai ka punuar si menaxher i programit për zhvillimin e lagjes si edhe drejtues i departamentit të prokurimeve të pasurive të paluajtshme. Prej katër vitesh punon në një korporatë të banesave sociale, në pozicionin e menaxherit të pasurive të paluajtshme. Ai është përgjegjës për mirëmbajtjen e 14,000 banesave si edhe për zhvillimin dhe zbatimin e programeve të qëndrueshmërisë për organizatën.



Valdet Sala ka qenë anëtare e Bordit Drejtues të Co-PLAN nga viti 2002 deri në vitin 2007 dhe konsulente e jashtme e organizatës që nga viti 1999. Aktualisht, ajo është menaxhere e një programi të GTZ/GOPA në përfshirjen e shoqërisë civile. Në karrierën e saj profesionale, Znj. Sala ka mbajtur poste të rëndësishme si Drejtoreshë e Bibliotekës Kombëtare, Drejtoreshë Programi tek Soros dhe konsulente mbi shoqërinë civile dhe çështjet gjinore. Ajo është themeluese e tri organizatave të cilat veprojnë kryesisht në çështjet gjinore dhe ka botuar një numër artikujsh mbi këto çështje si edhe ka përfaqësuar lëvizjen e femrave shqiptare në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2005 asaj iu dha çmimi Lidershipi Shqiptar për kontributin e vyer në sferën e shoqërisë civile.



Sef Sloodweg është një nga bashkëthemeluesit e Co-PLAN. Ai ka punuar për shumë vite për zyrën Holandeze për kërkim dhe këshillim të politikave, kryesisht në çështjet urbane dhe sfidat e banesave sociale. Në vitin 1990 ai themeloi fondacionin Crossover me synim shkëmbimin e eksperiencave në fushën e strehimit ndërmjet ekspertëve Holandezë dhe atyre Shqiptarë. Kjo ishte shtypa për të ardhur në Shqipëri, ku Z. Sloodweg u angazhua me studimet mbi rritjen e shpejtë dhe informale të zonave rezidenciale në Tiranë. Në vitin 1999 ai u bashkua organizatës SNV.

Peter Nientied është konsulent në fushën e zhvillimit organizativ dhe menaxhimit si edhe partner pranë De Boer & Ritsema van Eck (Holandë). Ka fituar gradën Master (me titull nderi) në Gjeografi Njerëzore dhe Planifikim dhe ka mbaruar studimet e doktoraturës në Shkenca Sociale nga Free University në Amsterdam si edhe një Master në Menaxhim Publik në Universitetin Twente në Holandë. Ai ka punuar për disa vite për IHS (Universiteti i Erasmusit, Rotterdam); gjatë kësaj periudhe ka ndërmarrë një sërë projektsh zhvillimore, kërkim dhe konsulencë në vende të ndryshme të Azisë, Amerikës Latine dhe Evropës. Në vitin 1999 ai iu bashkua kompanisë De Boer & Ritsema van Eck duke u specializuar në zhvillim organizativ, zhvillim lidhshpi dhe menaxhim projekti. Ai gjithashtu ofron konsulencë, trajnime dhe leksione në nivel Masteri mbi menaxhimin dhe lidhshpin. Peter Nientied ka qenë një bashkëpunëtor i Co-PLAN që në fillimet e tij. Në vitin 2008, Peter Nientied u bë bashkëdrejtuesi me kohë të pjesshme i Kërkimit dhe Programit të Doktoraturave në Universitetin Polis.



John Driscoll është Drejtori i Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillim Lokal dhe Rajonal (ICLRD), një qendër e kërkimit të aplikuar me vendndodhje në Armagh, Irlandë, e cila bashkon akademistë, praktikienë dhe politikëbërës të përfshirë në planifikim hapësinor dhe zhvillim lokal e rajonal. Z. Driscoll është gjithashtu Zv/President i Institutit për Zhvillimin Urban Ndërkombëtar në Kembrixh, Masaçusets, dhe një kërkues shkencor në Qendrën për Studime të Strehimit të Universitetit të Harvardit. Ai ka punuar me kolegë nga Shqipëria në vitet 1994-1998 me qëllim për të zhvilluar qasje me bazë komunitare për rindërtimin dhe integrimin e zonave informale si edhe për të çelur programin për menaxhimin e tokës të financuar nga Banka Botërore.



Fushat e ekspertizës së Co-PLAN

Siç shprehet më së miri në misionin e organizatës, Co-PLAN kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm urban e rajonal duke mbështetur qeverisjen e mirë, duke zhvilluar shoqërinë civile dhe duke fuqizuar komunitetet. Co-PLAN është themeluar dhe zhvilluar nën frymën dhe filozofinë e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje dhe kjo është pjesë e pandarë e organizatës.

Shërbimet dhe ekspertiza e organizatës u drejtohen institucioneve të ndryshme si pushtetit qendror dhe atij vendor, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit. Këto shërbime përqendrohen në:

- ⇒ Menaxhim Urban
- ⇒ Planifikim Strategjik
- ⇒ Planifikim dhe Menaxhim Mjedisor
- ⇒ Zhvillim Rajonal
- ⇒ Zhvillim Institucional dhe Organizativ
- ⇒ Studime dhe Kërkime Shkencore


Prej disa vitesh, Co-PLAN ka nisur përpjekjet për të shtrirë ndikimin e vet në sferat e larta të politikëbërjes, veçanërisht në çështjet që janë të lidhura me zhvillimin urban dhe atë rajonal, legalizimet, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin. Përtej këtyre, Co-PLAN është angazhuar në mënyrë aktive edhe në zhvillimet e reja në sektorin e shoqërisë civile, përfshirë këtu edhe ndërgjegjësimet dhe lobime me qëllim rritjen e autonomisë së këtij sektori dhe fuqizimin e rolit të tij.

Ndër ecuritë e organizatës për vitet e fundit duhet të përmendim edhe zhvillimin e një komponenti të ri, shumë pak ose aspak të trajtuar më parë në Shqipëri: menaxhimit financiar në nivel vendor. Ky hap ka ardhur në mënyrë të natyrshme pas punës së gjatë të organizatës në drejtim të hartimit të planeve strategjike të zhvillimit apo edhe të planeve rregulluese urbane për një sërë njësish vendore në vend. Për të mundësuar zbatimin e këtyre planeve nevojitet një ndryshim rrënjësor në mënyrën e menaxhimit të financave vendore, gjë e cila kërkon jo vetëm një ndryshim të modelit të menaxhimit financiar, por edhe krijimin e mendësisë së nevojshme për këtë qëllim. Vitet e fundit Co-PLAN është duke punuar me njësi të ndryshme të qeverisjes vendore

për të hartuar dhe zbatuar instrumente të cilat synojnë përmirësimin e situatës financiare të njësive vendore duke mundësuar thyerjen e rrethit vicioz “mungesë parash për investime - pengim i zhvillimit të ekonomisë vendore - më pak para për investime”.

Duke kuptuar dhe vlerësuar drejt rëndësinë e aspektit financiar në zhvillimin vendor, vitet e fundit Co-PLAN ka përfshirë në strukturën e tij disa projekte të kësaj natyre. Në të njëjtën kohë, Co-PLAN është duke mbështetur edhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit të vet në këtë fushë. Një ndër këto kontribute është edhe organizimi, në bashkëpunim me IHS, Holandë, i një kursi dyjavor me pjesëmarrje nga vende të ndryshme të rajonit, si Rumania, Lituania, Serbia, Shqipëria, Armenia etj. mbi çështje të menaxhimit financiar bashkiak dhe Planit të Investimeve Kapitale.

Vitet e fundit Co-PLAN ka forcuar ndikimin e vet në politikëbërje dhe vendimmarrje dhe ky hap ka ardhur natyrshëm pas fuqizimit të Co-PLAN si organizatë zhvillimi. Tani, njohuritë e përftuara nga organizata ndër vite do të përdoren për të ndikuar politikat dhe do të strukturohen përmes kërkimit shkencor.



Financat dhe transparenca

Si çdo vit, Co-PLAN auditohet nga një kompani prestigjioze në fushën e auditit financiar. Pasqyra e vlerësimit të kësaj kompanie për organizatën është bërë publike nëpërmjet këtij Raporti Vjetor i cili pasqyron punën e organizatës përgjatë një viti.

Raport i auditorëve të pavarur Për Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tiranë, më 21 Prill 2009

Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit (e quajtur këtej e tutje “Organizata” ose “Co-PLAN”) deri më 31 Dhjetor 2008, pasqyrën e të ardhurave dhe të fluksit të parave për vitin në fjalë si edhe një përmbledhje të politikave dhe standardeve të kontabilitetit dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Strukturave Menaxhuese për Pasqyrat Financiare

Strukturat menaxhuese janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare, bazuar në një kosto historike, sipas parimit të regjistrimit të dyfishtë, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”. Kjo përgjegjësi përfshin: dizenjimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e saktë dhe pa gabime të pasqyrave financiare; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave dhe standardeve të përshtatshme dhe vlerësimin financiar në përputhje me rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të japim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standardeve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përmbajnë gabime ose shmangie materiale.

Një auditim përfshin zbatimin e disa procedurave me qëllim marrjen e evidencës mbi shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi ynë, duke përfshirë edhe vlerësimin e risqeve për shmangie materiale në pasqyrat financiare. Gjatë vlerësimit të këtyre risqeve, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e saktë të pasqyrave

financiare me qëllim dizenjimin e procedurave të auditimit të cilat janë në përputhje me rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një mendim mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të organizatës. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga strukturat menaxhuese, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit e siguruar prej nesh siguron një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë gjykimin tonë.


Vlerësimi

Sipas vlerësimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të saktë të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2008 si dhe të performancës së saj financiare dhe të fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”.

Çështje të tjera

Ky raport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm të strukturave menaxhuese të Organizatës dhe për donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsye nuk duhet shpërndarë pa marrë më parë pëlqimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit
Kullat Binjake
Ndërtesa 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri





KPMG Albania Sh.p.k.
 "Dëshmorët e Kombit" Divisi
 Twin Towers Building,
 Building 1, 13th floor
 Tirana, Albania
 NPT 2916190010

Telephone: +355 4 2274 524
 +355 4 2274 534
 Telex: +355 4 2235 534
 E-mail: al-office@kpmg.com
 Internet: www.kpmg.al

Independent Auditors' Report

To The Executive Director of
 Co - PLAN

Tirana, 21 April 2009

We have audited the accompanying financial statements of Co-PLAN Institute for Habitat Development (hereafter "the Organisation" or "Co-PLAN"), which comprise the balance sheet as at 31 December 2008, the income statement and statement of cash flows for the year then ended, and a summary of significant accounting policies and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements on the historical cost basis, following the accrual concept in accordance with the fund-accounting method. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of financial statements that are free from material misstatements; whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditors' Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with relevant ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on our judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, we consider internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting principles used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

KPMG Albania Sh.p.k. is a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International, a Swiss entity.



We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

Opinion

In our opinion, the financial statements give a true and fair view of the financial position of the Organisation as at 31 December 2008, and of its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with the fund-accounting method.

Other Matters

This report is intended solely for the information and use of the Organisation's management and the donors of the Organisation. It is, therefore, not appropriate to rely on the contents for any other purposes and it should not, therefore, be further distributed without our prior written consent.

KPMG Albania Sh.p.k.

"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania





Projektet e Co-PLAN gjatë vitit 2008

- 1 **Ndikimi i Politikëbërjes**
- 2 **Drejt një Qeverisjeje të Mirë Urbane II – vazhdim**
- 3 **Përgatitja e Planeve Strategjike të Zhvillimit dhe Instrumenteve të Menaxhimit të Territorit (duke përfshirë Planet e Përgjithshme Rregulluese të Vaut të Dejës dhe Koplikut) në 6 njësi vendore të Rajonit të Shkodrës**
- 4 **Zbatimi i planit rregullues urban nëpërmjet promovimit të zhvillimit të zonës së ‘parkut’ si gjenerues zhvillimi për qytetin**
- 5 **Asistimi i Bashkisë së Kukësit për të formuluar një propozim të financueshëm për ndërtimin e Tregut Industrial nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje**
- 6 **NOSA- Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak**
- 7 **LGI – PIK, vizitë studimore në Republikën Çeke e përfaqësuesve të bashkive të Shqipërisë**
- 8 **Hapa Drejt një Shoqërie Gjithëpërfshirëse në Elbasan: Integrimi i Grupeve të Prekura në Zhvillimin Urban**



1 Ndikimi i Politikëbërjes

Periudha e Zbatimit: Dhjetor 2007 - Dhjetor 2010

Donatori: Instituti për Shoqërinë e Hapur, OSI, Budapest



Fondi: Për 2007-2008 \$ 65,000 - HRGGP OSI \$ 111,880 - Co-PLAN

Zbatohet në: Punë kërkimore e aplikuar në nivel kombëtar

Në vitin 2007, Co-PLAN mobilizoi një Program 3-vjeçar për Punë Kërkimore të Aplikuar për Politika Publike qendrore dhe vendore me qëllim ndikimin dhe ngritjen e politikave publike në një nivel më shkencor dhe mbi të gjitha me një fuqi vepruese dhe zbatuese më të mirë. Qëllimi i Co-PLAN është i dyfishtë: forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të brendshme në fushën e projekteve kërkimore dhe aplikimi i rezultateve të studimit të politikave me qëllim ndikimin e zhvillimit dhe zbatimit të tyre. Ky qëllim formësohet në një kontekst ku alternativat për politika të mirëfillta dhe të zbatueshme ose mungojnë ose ngrihen mbi debate dhe vendimmarrje ad-hoc. Gjatë periudhës 2007-2008, programi “Ndikimi i Politikëbërjes” synoi të influencojë arenën e politikëbërjes në Shqipëri përmes zhvillimit të punës studimore për tri tema specifike:

- Rajonalizimi i Shqipërisë dhe Efektet e tij në Organizimin Territorial
- Transferimi i Pronave Publike drejt Njësive të Qeverisjes Vendore
- Groposja dhe Trajtimi i Mbeturinave të Ngurta Urbane

Të tri temat janë politikisht të ndjeshme, prioritare dhe të diskutuara në nivele publike si dhe lidhen me çështjen e decentralizimit, fuqizimin e qeverisjes vendore dhe forcimin e marrëdhënieve midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjatë periudhës 2007-2008, ekipi i Co-PLAN është trajnuar për të hulumtuar me profesionalizëm të tri temat, ka përgatitur dokumente me rekomandime politike për qeverinë dhe grupet e interesit dhe ka diskutuar publikisht gjetjet e punës kërkimore. Gjithashtu, është zgjuar interesi i grupeve të ndryshme për t'u përfshirë në zbrëthimin e mëtejshëm të këtyre çështjeve si edhe janë gjeneruar nisma të tjera që mbështesin zbatimin dhe qëndrueshmërinë e programit “Ndikimi i Politikëbërjes”.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objektivi 1

Të fuqizohen kapacitetet e brendshme të Co-PLAN në drejtim të Punës Kërkimore të Aplikuar për Politika Publike qendrore dhe vendore

Treguesit
e arritjes

- Tre studime kërkimore janë përgatitur nga ekipi i Co-PLAN mbi temat përkatëse: (i) Rajonalizimi i Shqipërisë dhe Efektet e tij në Riorganizimin Territorial; (ii) Përse Procesi i Transferimit të Pronave Publike drejt Njësive të Qeverisjes Vendore Rrezikon të Dështojë?; dhe (iii) Groposja dhe Trajtimi i Mbeturinave të Ngurta Urbane – Një Eksperiencë e Munguar
- 4 ekspertë të Co-PLAN janë angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin kërkimor
- 11 punonjës të Co-PLAN kanë ndjekur 8 kurse profesionale jashtë vendit në financa bashkiake, strehim, administrim territori dhe FP7 si dhe kanë marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare për mbetjet e ngurta në Berlin
- Një ekspert i Co-PLAN është përfshirë në procesin e vlerësimit të mundësive për zhvillim rajonal përmes mbështetjes së Agjencive Zvicerane dhe Austriake për Zhvillim në Shqipëri
- 6 projekt-propozime janë përgatitur në kuadër të njohurive të programit dhe 3 prej tyre janë aprovuar nga donatorët (Login – OSI, EELGP – NL Embassy, REA - EU)
- Co-PLAN është abonuar dhe ka marrë botimet e 20 viteve të fundit për tre periodikë profesionale ndërkombëtarë (Local Government Studies, European Urban and Regional Studies, Waste Management and Research)
- Biblioteka e Co-PLAN/POLIS është pasuruar me 22 tituj për zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave të ngurta, menaxhimin mjedisor urban, pronat dhe pasuritë e patundshme, transportin urban dhe planifikimin e qëndrueshëm

Objektivi 2

Të ndikohen politikat publike në fushat përkatëse përmes zgjerimit të rrjetit të partnerëve dhe grupeve të interesit nga fusha akademike dhe e politikave publike dhe shpërndarjes së njohurive

Treguesit
e arritjes

- 3 dokumente politikash u janë paraqitur Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Integritimit Evropian, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencisë së Transferimit të Pronave Publike
- Co-PLAN ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi trepalëshe me Universitetin POLIS dhe me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Ministrinë e Mjedisit. Në këtë kuadër, Co-PLAN është edhe një ndër katër institucionet që formojnë institutin kërkimor shkencor të U-POLIS
- Një Komitet Kërkimor me 8 anëtarë nga institucione akademike dhe politike është ngritur, ka mbështetur punën kërkimore dhe është shprehur zyrtarisht në 2 takime të Komitetit
- Një grup me 6 ekspertë të jashtëm ka mbështetur procesin kërkimor
- 3 konferenca/tryeza kombëtare janë organizuar në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, U-POLIS, Shoqatën e Bashkive Shqiptare, Shoqatën e Këshillave të Qarqeve, Ministrinë e Integritimit, Ministrinë e Mjedisit, Programin LGPA të USAID dhe Platformën IDR për të diskutuar publikisht secilën nga tri temat
- 3 artikuj janë botuar në revistat Monitor dhe Ekselencia Shqiptare

2 Drejt një Qeverisjeje të Mirë Urbane II - vazhdim

Periodha e Zbatimit: 1 Janar 2007 – 31 Dhjetor 2008

Donatori: Qeveria Holandës nëpërmjet Ambasadës Holandeze në Tiranë

Fondi: 215,996 €

Zbatohet në: Bashkia Fier, Bashkia Elbasan

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objektivi 1

Institucionalizimi i procesit të Koordinimit dhe Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit

Treguesit e arritjes

- Dy trajnime janë organizuar në Bashkinë e Fierit dhe një trajnim në Bashkinë e Elbasanit në lidhje me Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit
- Realizimi i procesit të Monitorimit të Strategjisë për vitin 2008 nëpërmjet një bashkëpunimi të ARZH Fier, Bashkisë së Fierit dhe Co-PLAN

Objektivi 2

Përmirësimi i kapaciteteve vendore për zbërthimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit

Treguesit e arritjes

- Asistencë e vazhdueshme në punë për stafin lokal për detajimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues, e veçanërisht për dy zona prioritare në qytet
- Një rregullore e re e Departamentit të Urbanistikës, e cila reflekton Planin e Ri Rregullues, është hartuar dhe vënë në zbatim

Objektivi 3

Forcimi organizativ nëpërmjet zhvillimit të Sistemit të Informacionit Bashkiak

Treguesit e arritjes

- Një dokument përfundimtar i Analizës Institucionale të Bashkisë së Fierit është përgatitur nga grupi i punës
- Përshkrime të detajuara të punës janë përgatitur për çdo pozicion pune brenda Bashkisë së Fierit
- Rregullorja e Funksionimit të Brendshëm të Bashkisë së Fierit është përditësuar bazuar në dokumentin e Analizës Institucionale

Objektivi 4

Përmirësimi i Menaxhimit Financiar Bashkiak

Treguesit e arritjes

- Manuali për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale për njësitë e qeverisjes vendore është përgatitur, shtypur dhe shpërndarë në mbi 100 kopje në gjuhën shqipe
- Një version elektronik i Manualit për Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale në gjuhën angleze është shpërndarë në rrjetin e donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri
- Është përgatitur Plani i Investimeve Kapitale për Bashkinë e Fierit
- Është përgatitur një dokument i Analizës Financiare të Bashkisë së Fierit
- Dy trajnime mbi temat e Menaxhimit Financiar Bashkiak dhe Planit të Investimeve Kapitale janë përgatitur dhe zhvilluar si dhe është siguruar asistencë e vazhdueshme në punë për Bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit
- Një vizitë studimore në Republikën Çeke, ku ndër të tjerë morën pjesë edhe katër drejtues dhe punonjës të Bashkisë së Fierit, është zhvilluar me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e mundësive për të mësuar mbi temat e menaxhimit financiar bashkiak
- Procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje u zbatua për të katërtin vit në Bashkinë e Elbasanit dhe për të dytin vit në Bashkinë e Fierit me asistencën e Co-PLAN

Objektivi 5


Gjenerimi i fondeve / projekteve të tjera, bazuar në zbatimin e SZhQ

Treguesit e arritjes

- Rreth 1 milionë Euro, në formën e asistencës teknike apo edhe financimeve për investime, janë mundësuar për të dyja Bashkitë



Qëllimi i projektit “Drejt një Qeverisjeje të Mirë Urbane II - vazhdim”, i quajtur shkurtimisht EGUG II - vazhdim, është konsolidimi i modeleve të qeverisjes së mirë urbane të ngritur gjatë zbatimit të programit EGUG II në Bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit gjatë periudhës 2003-2006. Realizimi i këtij qëllimi është arritur nëpërmjet vënies në jetë të Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit (SZHQ) si edhe të Planit të Përgjithshëm Rregullues. Gjatë vitit 2008, i cili shënon edhe mbylljen e projektit, puna u përqendrua në zbërthimin e Planit Rregullues, i cilësuar si një nga instrumentet thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm; detajimin e Analizës Institucionale të Bashkisë; përgatitjen e dokumentit të Planit të Investimeve Kapitale; zbatimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe asistencën në zbërthimin dhe monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të qytetit, gjithnjë duke mbështetur dhe zhvilluar kapacitetet vendore. Një tjetër objektivi i projektit është edhe gjenerimi i fondeve apo projekteve nga të cilat do të përfitojnë Bashkitë e Fierit dhe të Elbasanit. Në këtë kuadër, janë mundësuar disa projekte nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm të cilët veprojnë në Shqipëri.



3 Përgatitja e Planeve Strategjike të Zhvillimit dhe Instrumenteve të Menaxhimit të Territorit (duke përfshirë Planet e Përgjithshme Rregulluese të Vaut të Dejës dhe Koplikut) në 6 njësi vendore të Qarkut të Shkodrës

Periudha e Zbatimit: Maj 2007 – Dhjetor 2008


Donatori: INTERCOOPERATION Albania - Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal

Fondi: 160,796 €

Zbatohet në: Bashkia Koplik, Bashkia Pukë, Bashkia Fushë-Arrëz, Bashkia Vau i Dejës Komuna Guri i Zi, Komuna Dajç, Bregu i Bunës

Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal në Rajonin e Shkodrës (DLDP), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga Intercooperation Albania, synon të mbështesë tetë Bashki dhe Komuna të këtij rajoni verior të Shqipërisë në lidhje me përmirësimin e komponentëve të qeverisjes vendore, menaxhimit dhe administrimit të shërbimeve. Në kuadër të zbatimit të programit, është parashikuar mbështetja e gjashtë njësi vendore në përgatitjen e “Planeve Strategjike të Zhvillimit” si edhe mbështetja për përgatitjen e Planeve të Përgjithshme Rregullues për Bashkinë e Koplikut dhe atë të Vaut të Dejës nëpërmjet pjesëmarrjes së gjerë të aktorëve vendorë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është “të përgatisë dokumentet strategjike që identifikojnë prioritetet kyç të zhvillimit për njësitë vendore të përzgjedhura në projekt dhe që orientojnë zhvillimet e ardhshme ekonomike, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit”. Procesi i punës u konceptua në funksion të rritjes së pjesëmarrjes qytetare në planifikim duke finalizuar secilën nga të katër fazat e projektit me një raund të posaçëm seminaresh. Bashkëpunimi me njësitë vendore u koordinua nëpërmjet ngritjes së gjashtë grupeve të punës brenda çdo njësie vendore me role dhe përgjegjësi të qarta.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të përgatiten gjashtë Planet Strategjike të Zhvillimit për Njësitë Vendore të përzgjedhura në projekt nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare

Treguesit
e arritjes

- 6 Analizat Përmbledhëse dhe drejtimet potenciale të zhvillimit për çdo njësi vendore janë përgatitur dhe diskutuar me të gjashtë grupet e përfaqësimit qytetar
- Vizionet dhe objektivat e zhvillimit për çdo njësi vendore janë identifikuar dhe shtjelluar në bashkëpunim me një numër aktorësh vendorë
- 12 seminare në gjashtë njësitë vendore janë organizuar me pjesëmarrjen e qytetarëve, gjatë dy raundeve të fundit
- Rreth 150 persona morën pjesë në seminarët pas çdo faze të projektit
- Rreth 25 takime janë organizuar me Grupet e Punës në çdo njësi lidhur me diskutimin e komponentëve të Planeve Strategjike të Zhvillimit
- 12 harta mbi Instrumentet e Menaxhimit të Territorit janë përgatitur dhe miratuar nga pjesëmarrësit në proces
- 6 Planet Strategjike të Zhvillimit kanë marrë miratimin përfundimtar nga Grupet e Qytetarëve, Këshillat Vendorë si dhe nga Këshilli i Qarkut Shkodër
- 300 kopje në shqip dhe 100 kopje në anglisht të Planeve Strategjike të Zhvillimit janë botuar për secilën nga të 6 njësitë vendore
- 500 kopje në shqip dhe 300 kopje në anglisht të Broshurave të Planeve Strategjike të Zhvillimit janë botuar për secilën nga të 6 njësitë vendore

Objekti 2

Të përgatiten Planet e Përgjithshme Rregulluese të qyteteve Vau i Dejës dhe Koplik

Treguesit
e arritjes

- 8 takime janë organizuar me grupet e punës me qëllim diskutimin e çështjeve të lidhura me përgatitjen e Detyrës së Projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues
- 36 harta tematike janë përgatitur për Detyrat e Projektimit për të dy qytetet
- 2 Detyrat e Projektimit janë finalizuar dhe miratuar në KRrT-të e Bashkisë Vau i Dejës dhe Koplik si edhe në KRrT-në e Qarkut Shkodër
- 6 seminare u zhvilluan në tri fazat e para të Projektit, ku u diskutua mbi format dhe drejtimet e transformimit të territoreve urbane në të dy Bashkitë
- 10 takime me Grupet e Punës janë organizuar me qëllim diskutimin e elementeve të propozimeve territoriale të Planeve Rregulluese për të dy qytetet
- 2 Planet Rregulluese janë finalizuar së bashku me projekt-idetë për rrjetet e infrastrukturave si edhe studimet përkatëse të Ndikimit në Mjedis
- 38 harta tematike janë përgatitur për Planet Rregulluese të të dy qyteteve
- 2 Plane Rregulluese janë miratuar në KRrT-të përkatëse të Bashkive Vau i Dejës dhe Koplik

4 Zbatimi i planit rregullues urban nëpërmjet promovimit të zhvillimit të zonës së “parkut” si gjenerues zhvillimi për qytetin


Periudha e Zbatimit: Shtator 2008 - Maj 2009


Donatori: Programi LGPA i financuar nga USAID dhe zbatuar nga ARD, Inc.

Fondi: ALL 2,125,000

Zbatohet në: Bashkia e Fierit

Projekti “Zbatimi i planit rregullues urban nëpërmjet promovimit të zhvillimit të zonës së ‘parkut’ si gjenerues zhvillimi për qytetin” synon krijimin e një Partneriteti Publik-Privat (PPP) për zhvillimin e zonës së ‘Parkut’. Co-PLAN është duke asistuar Bashkinë e Fierit nëpërmjet Programit LGPA të zbatuar nga ARD, Inc. në hartimin e një projekti të financueshëm për ndërtimin e një Terminali Autobusësh së bashku me shërbimet përkatëse në zonën e ‘parkut’. Rizhvillimi i zonës do të ndihmojë ekonominë e qytetit nëpërmjet gjenerimit të investimeve publike dhe private dhe do të sigurojë një instrument për zbatimin e Planit Rregullues Urban dhe Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit. Objektivat kryesore të projektit janë: (i) të rivlerësojë dhe përmirësojë propozimin për planin e zhvillimit të zonës duke marrë në konsideratë komentet dhe kërkesat e aktorëve; (ii) të përgatisë dhe hartojë studimin e fizibilitetit për zonën; (iii) të asistojë bashkinë e Fierit gjatë marketimit të projektit dhe (iv) të mbështesë bashkinë e Fierit gjatë zbatimit të projektit. Gjatë vitit 2008, aktivitetet e projektit u fokusuan në dy objektivat e para siç detajohet edhe në tabelën e treguesve të arritjeve.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJEVE

Objekti 1

Të rivlerësohet dhe përmirësohet plani i zhvillimit duke marrë në konsideratë komentet dhe kërkesat e aktorëve të përfshirë

Treguesit e arritjeve

- Është grumbulluar informacioni në lidhje me infrastrukturën, çështjet e pronësisë dhe problematikat ambientale
 - i. 30 intervista u zhvilluan me banorët e zonës
 - ii. 4 harta tematike, përkatësisht për përdorimet e tokës, çështjet e pronësisë, problematikat ambientale dhe infrastrukturën, janë duke u përgatitur
- Harta e pronësisë mbi tokën dhe banesat është duke u përgatitur
 - i. 2 takime janë organizuar me pronarët më të mëdhenj të tokës në zonë
 - ii. Është bërë rievimi i të dhënave të grumbulluara në terren

Objekti 2

Të përgatitet dhe të hartohet studimi i fizibilitetit për zonën

Treguesit e arritjeve

- 2 intervista të thelluara janë bërë me investitorë të interesuar për të investuar në zonë
- Janë identifikuar investitorë potencialë për terminalin e autobusëve
- Skema e lëvizjes së automjeteve për zonën është duke u përgatitur

5 Asistimi i Bashkisë së Kukësit për të formuluar një propozim të financueshëm për ndërtimin e Tregut Industrial nëpërmjet një proçesi me pjesëmarrje

Periodha e Zbatimit: Tetor 2008 – Prill 2009

Donatori: ARD / USAID

Fondi: 16,555 €

Zbatohet në: Bashkia Kukës

Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar më 23 Janar 2008 midis USAID dhe Bashkisë së Kukësit në kuadër të Programit për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), të financuar nga USAID dhe të zbatuar nga ARD, është miratuar përgatitja e një propozimi të financueshëm për ndërtimin e një Tregu të ri Industrial në Qytetin e Kukësit. Qëllimi i projektit është përgatitja e kuadrit të nevojshëm teknik dhe institucional që do të çojë në zhvendosjen e tregut ekzistues të qytetit në një ambient të përshtatshëm, përmirësimi i klimës së biznesit vendas dhe stimulimi i zhvillimit ekonomik të qytetit të Kukësit. Bashkia Kukës, nëpërmjet një analize paraprake, ka identifikuar tri zona potenciale në qytet për ndërtimin e Tregut të ri Industrial. Në këtë kuadër, Co-PLAN është angazhuar në rolin e konsulentit i cili do të menaxhojë procesin për përgatitjen e këtij propozimi. I gjithë procesi i punës do të kryhet në bashkëpunim me Bashkinë e Kukësit e cila ka ngritur një grup të posaçëm pune për këtë qëllim.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objektivi 1

Të përgatitet një vlerësim i përgjithshëm i tri zonave të marra në shqyrtim duke identifikuar zonën më të përshtatshme për ngritjen e Tregut të ri Industrial

Treguesit e arritjes

- 250 pyetësorë janë plotësuar në zonën e tregut ekzistues me qëllim identifikimin e opinionit të tregtarëve lokalë, të banorëve dhe përdoruesve të tregut lidhur me ngritjen e një tregu të ri industrial në qytet
- 1 raport final i përgatitur nga një organizatë lokale pasqyron analizën e pyetësorëve të plotësuar në terren
- 40 përfaqësues të tregtarëve ekzistues në qytet kanë shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në procesin e përgatitjes së modelit të Tregut të ri Industrial
- 1 draft-dokument i vlerësimit të tri zonave të identifikuara është përgatitur për t'u diskutuar me Bashkinë e Kukësit dhe me grupe të tjera të interesit

Objektivi 2

Të përgatitet modeli arkitektonik dhe urbanistik për ndërtimin e Tregut të ri në Zonën e Përzgjedhur, në bashkëpunim me grupet e përfaqësimit lokal

Treguesit e arritjes

- 3 vizita në terren janë organizuar për të identifikuar elemente të nevojshëm gjatë procesit të analizës dhe përgatitjes së modelit urbanistik dhe arkitektonik
- 2 takime me grupin e punës janë organizuar për të diskutuar temat e mundshme urbane apo rajonale që duhet të orientojnë procesin e përgatitjes së modelit të një tregu të ri për qytetin.
- Materiale hartografike dhe fotografike të nevojshme për përgatitjen e një modeli urbanistik dhe arkitektonik janë siguruar nëpërmjet projektit

Objektivi 3

Të përgatitet Studimi i Fizibilitetit për ndërtimin e Tregut të ri, në bashkëpunim me grupet e përfaqësimit lokal si edhe në funksion të modelit të përpunuar arkitektonik dhe urbanistik

Treguesit e arritjes

- 6 institucione kryesore publike në qytetin e Kukësit si Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Transportit Rrugor, Drejtoria e Policisë së Qarkullimit, Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve, Albtelekom Kukës dhe Zyra e OSSH për Kukësin janë kontaktuar me qëllim identifikimin e mendimeve dhe komenteve të përfaqësuesve të tyre lidhur me mundësinë dhe kërkesat e një Tregu të ri Industrial
- Një bazë paraprake të dhënash është ngritur, e nevojshme kjo për analizën e fizibilitetit për secilën nga të tri zonat



6 Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak

Periodha e Zbatimit: Janar-Dhjetor 2008

Donatori: OSFA/SOROS



Fondi: USD 75,015

Zbatohet në: Bashkia Durrës, Bashkia Lezhë, Bashkia Fier

Shumë prej bashkive në Shqipëri kanë hartuar plane strategjike zhvillimi, disa prej tyre më tepër se një. Megjithatë, pavarësisht tipit, cilësisë apo afateve kohore, shumica e strategjive nuk janë zbatuar asnjëherë plotësisht. Financat e munguara, politikat e vjetruara të menaxhimit financiar, të shoqëruara me përgjegjësitë dhe kompetencat në rritje, ndikojnë në aftësinë e pushtetit vendor për të punuar me planet (strategjitë). Për rrjedhojë, sfida më e madhe në nivel vendor mbetet zbatimi i këtyre planeve.

Gjatë vitit 2008, Co-PLAN ka punuar me dy prej bashkive të përfshira në projektin DELTA, atë të Durrësit dhe atë të Lezhës, duke i asistuar ato në gjetjen e mënyrave për të përzgjedhur dhe financuar investimet e tyre. Në të dy bashkitë, projekti u përqendrua në hartimin e planeve dhe buxheteve të investimeve kapitale si dhe në përgatitjen e buxheteve vjetore me pjesëmarrjen e qytetarëve. Një qasje e njëjtë u aplikua edhe në Bashkinë e Fierit e cila, në kuadër të këtij projekti, u asistua në zbatimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje. Përveç hartimit të Planit të Investimeve Kapitale, është e rëndësishme të garantohet edhe monitorimi i zbatimit të investimeve kapitale të parashikuara në plan dhe i shpenzimeve të tjera.

Për këtë arsye, gjatë zbatimit të projektit, Co-PLAN ofroi trajnime për organizatat lokale dhe OJQ-të në monitorimin e buxhetit vjetor dhe zbatimin tij sipas PIK të hartuar. E gjithë kjo paketë ndihmon në forcimin e autonomisë lokale në kuadër të decentralizimit fiskal.





Shprehja	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Investimet kapitale	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Durrësit	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Lezhës	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Fierit	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000

Shprehja	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Investimet kapitale	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Durrësit	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Lezhës	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
Investimet kapitale të bashkive të Fierit	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000

PARASHIKIMI I FONDVEVE TË MUNISIMIT TË VETË - në mijë Lekë	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1.1. Fondet e investimit të veta vendore									
Transferimet pa kushte	100.750	82.000	121.632	142.052	175.188	200.626	247.351	207.541	357.049
Likuid dhe variet të veta vendore	209.457	334.931	342.071	312.495	252.225	499.626	613.321	706.629	856.313
1.2. Fondet e ndihmës të pushtetit vendor në total									
Investimet kapitale (fondet e vetë)									
Keshilli Bashkiak	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Administrimi e Përgjithshme	27.500	84.721	83.601	97.708	129.092	149.600	170.600	200.600	230.000
Arsimi	12.200	13.141	14.000	16.000	16.244	14.020	12.800	9.500	5.000
Kultura dhe Sporti	60.000	67.268	83.201	93.185	93.528	109.000	115.000	132.000	145.000
Shëndetësia	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rehabilitimi Social	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Punë dhe Varietet	12.400	10.571	8.114	8.144	7.019	8.000	8.000	9.500	10.000
Punë dhe Mirëqenie e shtëpisë	45.700	45.300	30.300	35.000	40.500	77.000	80.000	100.000	115.000
Punë Publike	13.900	54.152	83.714	69.000	86.476	100.000	120.000	110.000	120.000
Transporti Publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qendra Civile	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Et gjithë shumicën e sipas	0	14.000	12.600	8.700	10.644	20.000	25.000	35.000	40.000
Shprehja kapitale në total	393.607	364.013	548.524	612.437	612.166	867.252	1.046.518	1.043.652	1.493.413
Fondi e ndihmës të pushtetit vendor	36.185	128.476	149.876	184.318	152.887	236.205	326.942	441.908	618.758

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJEVE

Objektivi I

Forcimi i kapaciteteve lokale në përgatitjen e Planeve të Investimeve Kapitale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë menaxhimit financiar dhe gjetjes së mënyrave alternative për të rritur burimet financiare.

Treguesit e arritjes

- U përgatitën dhe u ofruan tri paketa trajnimi për dy bashkitë e Durrësit dhe të Lezhës në fushat e huamarrjes vendore, grumbullimit dhe rritjes së të ardhurave dhe taksave dhe praktikave të reja të menaxhimit financiar bashkiak.
- Tri bashkitë e Durrësit, Fierit dhe Lezhës dhe një numër prej rreth 70 specialistësh përfituan prej këtyre trajnimeve.
- Rreth 18 specialistë në bashkitë e Durrësit dhe të Lezhës, të departamenteve të taksave, financave, planifikimit urban, monitorimit të strategjive etj., janë asistuar gjatë punës.
- U përgatit metodologjia për përmirësimin e grumbullimit të të ardhurave lokale

Objektivi II

Përgatitja e Planit të Investimeve Kapitale për qeveritë lokale

Treguesit e arritjes

- U përgatit metodologjia për hartimin e PIK në nivel lokal
- U përgatit metodologjia për përzgjedhjen e Projekteve Kapitale
- U përgatit Plani i Investimeve Kapitale në bashkinë Lezhë
- U përgatit Plani i Investimeve Kapitale në bashkinë Durrës
- U përgatit manuali për hartimin e PIK në nivel lokal

Objektivi III

Asistimi i njësive vendore në zbatimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje

Treguesit e arritjes

- U hartua metodologjia për zbatimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në bashkinë e Lezhës.
- Rreth 350 qytetarë u përfshinë në proces.
- U përgatitën dhe shpërndanë 2,000 fletëpalosje dhe 500 postera për informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve.
- Nëntë projekte të përzgjedhur prej banorëve u përfshinë në buxhetin e bashkisë për vitin 2009, me një vlerë totale prej 30,5 milionë Lekësh.

Objektivi IV

Trajnimi i organizatave lokale dhe OJQ-ve për monitorimin e buxhetit dhe zbatimin e Planit të Investimeve Kapitale

Treguesit e arritjes

- U përgatitën katër trajnime për organizatat lokale në lidhje me monitorimin e buxhetit vjetor dhe zbatimin e PIK.
- 33 organizata lokale prej bashkive të Lezhës, Durrësit dhe Fierit u trajnuan për monitorimin e PIK
- 57 persona morën pjesë në trajnimet për monitorimin e PIK në Lezhë, Durrës dhe Fier

7 Mundësimi i qeverisjes së mirë nëpërmjet përmirësimit të praktikave të menaxhimit financiar bashkiak – Vizita Studimore për PIK (Plani i Investimeve Kapitale) me përfaqësues të bashkive shqiptare në Republikën Çeke

Periudha e Zbatimit: Korrik - Nëntor 2008

Donatori: LGI - OSI, Budapest - Hungari

Fondi: USD 26,396

Zbatohet në: Bashkinë Durrës, Bashkinë Lezhë, Bashkinë Fier

Nëpërmjet programit DELTA, pesë bashki në Shqipëri (përkatësisht bashkitë Shkodër, Durrës, Lezhë, Berat dhe Korçë), janë asistuar në përgatitjen e planeve të tyre strategjike të zhvillimit nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje. Në fillim të vitit 2008, OSI Budapest miratoi projekt- propozim e dorëzuar nga Co-PLAN për një projekt në vazhdim në bashkitë që janë pjesë e DELTA. Ky projekt kishte për qëllim të konsolidonte kapacitetet bashkiake për të punuar me Planet e Zhvillimit Ekonomik Vendor nëpërmjet përdorimit të Planit të Investimeve Kapitale si një instrument për vënien në zbatim të PZhE në nivel vendor. Në kuadër të projektit të miratuar me titull: “Mbështetja e vazhduar DELTA në bashkitë e përzgjedhura” si edhe në përputhje të plotë me një nga objektivat kryesorë të projektit që lidhet me ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore për çështjet bashkiake, përgjatë vitit të parë të projektit, Co-PLAN në bashkëpunim me AGORA CE, përgatiti dhe organizoi një vizitë studimore në Republikën Çeke me përfaqësues të bashkive Durrës, Lezhë dhe Fier. Qëllimi kryesor i projektit konsistonte në: Të organizojë një vizitë studimore në Republikën Çeke në kuadër të forcimit të kapaciteteve bashkiake për të punuar me Planet e Zhvillimit Ekonomik Vendor nëpërmjet hartimit të planeve të investimeve/përmirësimeve kapitale, hartimit dhe menaxhimit të buxheteve kapitale, vënies në përdorim të sistemeve dhe praktikave të cilat lehtësojnë procesin e huamarrjes vendore dhe përmirësojnë njohjen e besueshmërinë si edhe përmirësimit të sistemit të mbledhjeve të taksave duke ndërtuar praktika të reja të menaxhimit financiar.





Qëllimi i këtij projekti u zbërthye më tej në objektiva më të detajuar si:

Objektivi 1: të njohë dhe ndajë eksperiencën me stafin bashkiak të Republikës Çeke lidhur me sistemin e taksave dhe mbledhjes së të ardhurave


Objektivi 2: të njohë dhe diskutojë çështje që lidhen me huamarrjen vendore dhe buxhetimin në nivel bashkiak

Objektivi 3: të njohë dhe diskutojë çështje që lidhen me procesin e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale dhe huatë përkatëse.

Rezultatet & ndikimet e kësaj vizite studimore:

(i) Dhjetë specialistë të bashkive Durrës, Fier dhe Lezhë, morrën pjesë në një vizitë studimore për çështje të financave bashkiake dhe PIK të organizuar në Republikën Çeke

(ii) Tre anëtarë të stafit Co-PLAN u përfshinë drejtpërsëdrejti në projekt duke fituar eksperiencë dhe zgjeruar idetë e tyre lidhur me çështje të ndryshme të menaxhimit financiar, duke u bazuar në eksperiencën e Republikës Çeke.



8 Hapa Drejt një Shoqërie Gjithëpërfshirëse në Elbasan: Integrimi i Grupeve të Prekura në Zhvillimin Urban

Periodha e Zbatimit: Dhjetor 2006 - Dhjetor 2008

Donatori: CORDAID, Bashkia e Elbasanit

Fondi: 247,538 € / 5,000,000 ALL

Zbatohet në: Bashkia e Elbasanit

Viti 2008 shënoi mbylljen me sukses të projektit “Hapa Drejt një Shoqërie Gjithëpërfshirëse në Elbasan: Integrimi i Grupeve të Prekura në Zhvillimin Urban”, hartimi dhe zbatimi i të cilit u bazua në Strategjinë e Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit, të hartuar në kuadër të programit EGUG II, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom. Projekti ka përfunduar zbatimin në lagjen “5 Maji” ku është i vendosur komuniteti Rom, i karakterizuar nga probleme të ndryshme të natyrës social-ekonomike dhe të aksesit në shërbime publike, të lidhura me situatën informale të kësaj lagjeje. Ky projekt synoi realizimin e aktiviteteve që çojnë në integrimin e këtij komuniteti në zhvillimin e mëtejshëm urban të qytetit, në mënyrë që anëtarët e tij të ndihen qytetarë të barabartë të këtij qyteti në të ardhmen. Dy nga përmasat kryesore të projektit konsistuan në realizimin e investimeve konkrete në zonë, bazuar në identifikimin e prioriteteve në komunitet, dhe në hartimin dhe botimin e një dokumenti lokal mbi planifikimin e zhvillimit të lagjes, i cili është në përputhje me dokumentin kombëtar të strategjisë mbi Romët në Shqipëri dhe do të shërbejë si një instrument matës i arritjes së objektivave në



nivel lokal. Pjesë integrale e projektit ishte edhe asistenca për rritjen e kapaciteteve të popullsisë Rome, me qëllim rritjen e rolit të tyre në vendimmarrjen vendore, si edhe të pushtetit lokal me qëllim ndërtimin e urave të qëndrueshme të bashkëpunimit institucional mes autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të komunitetit Rom në zonë.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të nxisë dhe të aftësojë pjesëmarrjen e komunitetit Rom në proceset e vendimarrjes

Treguesit
e arritjes

- 20 takime u organizuan me komunitetin Rom në zonë dhe me përfaqësuesit e tyre
- Rreth 100 individë, banorë të zonës dhe staf i Bashkisë, morën pjesë në 5 cikle trajnimesh

Objekti 2

Të fuqizojë kapacitetet vendore mbi politikëbërjen dhe praktikat që adresojnë nevojat e komunitetit Rom në shoqëri

Treguesit
e arritjes

- 280 kopje të botimit Axhenda e Zhvillimit të Lagjes janë shpërndarë tek autoritetet vendore, organizata me bazë komunitare “Zëri Rom” dhe aktorë të tjerë që operojnë në nivel vendor
- 3 përfaqësues të komunitetit Rom kanë marrë pjesë aktivisht gjatë procesit të buxhetimit me pjesëmarrje të zhvilluar nga Bashkia e Elbasanit
- Organizata me bazë komunitare “Zëri Rom” përfundoi procedurat e regjistrimit në bazë të ligjit Shqiptar mbi OJF-të
- 2 trajnime me 30 pjesëmarrës janë organizuar me stafin e Bashkisë
- 1 *workshop* është organizuar me grupin e punës së Bashkisë përgjegjës për Buxhetimin me Pjesëmarrje duke u fokusuar tek zbatimi i Axhendës së Zhvillimit të Lagjes

Objekti 3

Të rrisë ndërgjegjësimin dhe aftësitë lobuese mbi çështjen Rome ndër të gjithë aktorët lokalë dhe qytetarët

Treguesit
e arritjes

- 1,000 qytetarë Romë pjesëmarrës në aktivitetin e organizuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve dhe Festës së Shën Gjergjit
- 1,000 fletëpalosje të shpërndara me rastin e këtyre festave
- 12 numra të Gazetës së Përmuajshme të Bashkisë me përfshirjen e mbi 10 artikujve ndërgjegjëses mbi çështjen Rome
- 2 artikuj pasqyrues të aktiviteteve të projektit të publikuara në gazetën e përditshme kombëtare “Gazeta Shqiptare”
- 5 kronika televizive mbi ndërgjegjësimin ndaj çështjes Rome të pasqyruara në televizionin lokal të Elbasanit “ETV”
- 2 intervista dhe pasqyrime të organizimit të aktiviteteve masive në Ditën Ndërkombëtare të Romëve dhe Festën e Shën Gjergjit në televizionet “News 24” dhe Elbasan TV

Objekti 4

Të përmirësojë aksesin e qytetarëve Romë në infrastrukturën fizike dhe atë sociale me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës

Treguesit
e arritjes

- 250 familje janë përfituese të ndërhyrjes për Rehabilitimin e Përroit të Çamurrit në 580,2 metra gjatësi të përroit
- Rrjeti i KUZ është ndërtuar në lagjen Rome (19 puseta të ndërtuara, 396 ml tuba të vendosur për lidhjet parësore dhe dytësore, 565 m³ kanal i hapur)
- Infrastruktura e rrugës kryesore të lagjes Rome është përmirësuar ndjeshëm
- 20 kosha metalikë të përmasave 1,1 m³ të vendosur në lagjen Rome shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe higjienën publike
- 65 ndriçues rrugorë janë vendosur në të gjithë lagjen Rome duke rritur ndjeshëm sigurinë e komunitetit Rom



9 Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integritimit të Komunitetit të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës

Periodha e Zbatimit: Dhjetor 2006 - Dhjetor 2008

Donatori: Qeveria Austriake nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA),
Bashkia e Durrësit, Co-PLAN

Fondi: 490,713 €

Zbatohet në: Zona Informale Kënetë, Durrës

Projekti “Hapa drejt Rehabilitimit Urban dhe Integritimit të Komunitetit të Zonës me Zhvillim Informal Kënetë, Durrës” u çel zyrtarisht në Maj 2004 dhe është bashkëfinancuar nga Qeveria Austriake, Bashkia e Durrësit dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Fillimisht, projekti ishte parashikuar të përfundonte në Prill 2007 por, si rezultat i procesit të legalizimit dhe i zhvillimeve lidhur me situatën e investimeve në zonë, afati i projektit u shty për në muajin Qershor 2008. Qëllimi i projektit ishte zhvillimi dhe integrimi social dhe hapësor i komunitetit i cili banon në këtë zonë informale në qytet. Pjesëmarrja e komunitetit të zonës përbënte edhe gurin e themelit përgjatë zbatimit të projektit, si në drejtim të hartimit të vizionit për zhvillimin e zonës, ashtu edhe në drejtim të zbatimit të këtij plani dhe integritimit të zonës pilot me pjesën tjetër të qytetit.

Tabela e treguesve paraqet rezultatet e arritjeve të projektit vetëm për periudhën shtesë të kontratës, e cila kryesisht synoi finalizimin e ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës dhe koordinimin e gjithë investimeve në zonë. Për këtë arsye, aktivitetet e zbatuara gjatë kësaj periudhe u përqendruan në: (i) finalizimin e ndërhyrjeve për shtrimin me çakëll të rrugës kryesore të zonës; (ii) vijimësinë e përhapjes së eksperiencës së projektit; (iii) organizimin e një vizite nga ana e ekspertëve Austriakë brenda muajit Qershor dhe (iv) organizimin e aktivitetit përmbyllës të projektit. Ky projekt sjell një model për integrimin e komuniteteve të cilat banojnë në zonat informale. Krijimi i një baze të dhënash e cila lehtëson procesin e legalizimit, përgatitja e një plani zhvillimi me pjesëmarrje dhe përmirësimi i zonës nëpërmjet organizimit dhe fuqizimit të komunitetit janë elementet kyç të cilat kanë materializuar ndikimin e projektit në zonën përfituese. Asistenca teknike e dhënë për stafin e Bashkisë së Durrësit si edhe për ekspertët e njësive vendore të ALUIZNI-t në përgatitjen e studimeve urbane për zonën dhe në krijimin e bazës së të dhënave ishte qasja që iu përshtat më së miri nevojave të pushtetit vendor për integrimin e zonave të zhvilluara në mënyrë informale. Sot, zona pilot e Kënetës ka thithur më shumë investime se çdo zonë tjetër në qytetin e Durrësit.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të përmirësohet infrastruktura në zonën pilot

Treguesit e
Arritjes

- 25,600 m² apo 3,200 metra linearë rrugë janë përmirësuar në zonën pilot

Objekti 2

Të përhapet njohuria ndërmjet aktorëve të interesuar

Treguesit e
Arritjes



- 2 dokumentarë janë përgatitur dhe transmetuar në televizionet lokale në lidhje me arritjet e projektit
- 250 kopje të broshurës së projektit janë shpërndarë

Objekti 3

Të organizohet aktiviteti përmbyllës i projektit

Treguesit e
Arritjes

- Një ekspozitë me fotografi të marra gjatë zbatimit të projektit u organizua në zyrën e projektit
- Një aktivitet festiv u organizua me rastin e përfundimit të fazës së ndërhyrjeve për përmirësimin e lagjes
- Një vizitë e ekspertëve Austriakë u organizua në Qershor 2008



10 Rikualifikimi mjedisor i zonës mes unazës Skënderbeu dhe blloqeve të pallateve “Liri Gero” dhe “8 Shkurti” nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare

Periodha e Zbatimit: 13 Qershor 2008 – 15 Nëntor 2008

Donatori: Qendra Rajonale e Mjedisit – REC Shqipëri, Bashkia e Fierit

Fondi: ALL 4,555,360 ALL 911,072

Zbatohet në: Bashkia Fier

Ky projekt ka konsistuar në rehabilitimin mjedisor të një sipërfaqeje prej 5,300 m² të vendosur ndërmjet unazës Skënderbeu dhe blloqeve të banimit “Liri Gero” dhe “8 Shkurti”. Ndërsa investimi fizik është një komponent i rëndësishëm i këtij projekti, aspektet sociale dhe ato institucionale kanë qenë gjithashtu një pjesë përbërëse e tij. Përpara realizimit të investimit, zona në fjalë ishte në gjendje të degraduar. Ajo qe kthyer në një vatër të mundshme sëmundjesh dhe shërbente si një imazh negativ për qytetin duke qenë se ndodhej në një nga pikat kryesore hyrëse të tij. Rreth 10,000 banorë të zonës ku është realizuar investimi janë përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti. Bashkia e Fierit ka qenë një partner mjaft aktiv përgjatë të gjitha fazave të zbatimit të projektit duke kontribuar edhe me 20% të shumës në kuadër të plotësimit të kushtit të bashkëfinancimit.

Është e rëndësishme të thuhet se ky investim shërbeu edhe për të gjeneruar një tjetër investim, këtë herë me fonde të Qeverisë Qendrore. Ky investim mundësoi sistemimin e trotuareve për këmbësorë dhe instalimin e ndriçimit publik në zonë. Të dyja këto investime kanë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës dhe rrjedhimisht edhe të cilësisë së jetës së banorëve të kësaj zone.





OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të rehabilitohet dhe të gjelbërohet një sipërfaqe prej 5,300 m²

Treguesit e arritjes

- Një sipërfaqe prej 5,300 m² është rehabilituar
- Një sipërfaqe prej 4,461 m² është gjelbëruar me bar
- 2 puse për ujë janë instaluar në zonën e investimit
- 20 kosha për mbeturinat janë vendosur në zonë

Objekti 2

Të përmirësohet cilësia e ajrit nëpërmjet krijimit të një barriere me pemë në zonën e investimit

Treguesit e arritjes

- 102 pemë dekorative, nga të cilat 42 pemë gjethembajtëse dhe 60 pemë gjetherënëse, janë mbjellë në zonë duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e ajrit nëpërmjet kapjes së pluhurit dhe rritjes së sasisë së oksigjenit të prodhuar

Objekti 3

Të mundësohet ndërveprimi shoqëror ndërmjet banorëve të zonës

Treguesit e arritjes

- 10,000 banorë të zonës janë përfitues të drejtpërdrejtë të investimit
- 50 stola druri janë vendosur në zonë, duke rritur ndjeshëm mundësitë e ndërveprimit ndërmjet banorëve të zonës
- 5 rrugica të reja lidhin lulishten e sapondërtuar me pjesët e brendshme të pallateve, duke lehtësuar ndërveprimin e banorëve të zonës
- Qindra fëmijë shkolle përfitojnë nga ky investim për shkak të afërsisë së shkollës me lulishten e sapondërtuar

Objekti 4

Të rritet ndërgjegjësimi publik mbi çështjet mjedisore dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike

Treguesit e arritjes

- Disa takime dhe aktivitete janë zhvilluar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të banorëve mbi rolin e tyre në menaxhimin mjedisor
- 3 trajnime janë zhvilluar me stafin e Bashkisë mbi tri tematika të ndryshme mjedisore, përfshirë këtu edhe një trajnim mbi rolin e pjesëmarrjes qytetare në menaxhimin mjedisor
- Qindra banorë të zonës ku u zbatua projekti morën pjesë në ceremoninë përmbyllëse të projektit

11 LOGIN – Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore

Periudha e Zbatimit: 1 Shtator 2008 – 31 Dhjetor 2008

Donatori: LGI & Instituti për një shoqëri të hapur, Budapest

Fondi: \$ 37,000

Zbatohet në: Shqipëri

Qëllimi i LOGIN – Rrjetit të informacionit mbi qeverisjen vendore - konsiston në promovimin e zhvillimit profesional të specialistëve të pushtetit vendor si edhe në forcimin e kapaciteteve të organizatave që mbështesin reformat në administratën publike në nivel vendor. Ky projekt zbatohet njëkohësisht në 15 vende ish-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore të cilat i janë dedikuar krijimit të platformës së njohurive LOGIN; kjo platformë ofron informacion mbi çështje të qeverisjes vendore. Ndër të tjera, kjo bazë të dhënash përmban të reja në lidhje me zhvillimet në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian duke u fokusuar në urdhëresat që duhen zbatuar si edhe në mundësitë e shfaqura. Gjatë harkut kohor Shtator-Dhjetor 2008, është bërë i mundur funksionimi i bazës së të dhënave LOGIN në faqen zyrtare të Co-PLAN www.co-plan.org, e cila përfshin nëntë module si: legjislacioni, libraria, mundësi financimi, trajnime, integrimi evropian, kalendari, të reja, publikime dhe website të tjera. Gjatë kësaj periudhe, u vendosën në platformë 60 dokumente dhe materiale që kanë si qëllim përditësimin e punonjësve të administratës vendore me informacion dhe zhvillime të fushës. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është partneri kyç i Co-PLAN në mundësimin e funksionimit sa më efikas të kësaj platforme.

LOGIN- Rrjeti Informativ i Pushtetit Vendor www.logincee.org



LOGIN është rrjeti informativ i qeverisjes vendore i krijuar për të nxitur dhe promovuar zhvillimin profesional të zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe stafit të tyre. LOGIN lehtëson shkëmbimin e informacionit nëpërmjet internetit dhe metodave tradicionale si: seminare, botime, konferenca, trajnime, etj.

Misioni i LOGIN është të promovojë zhvillimin profesional të zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe të stafit të tyre, të

fuqizojë kapacitetet e organizatave që mbështesin reformën e administrimit publik dhe decentralizimin duke lehtësuar kohën për shkëmbimin dhe marrjen e informacionit të dobishëm në nivel bashkiak, rajonal dhe kombëtar, në të gjitha vendet e Evropës Jug-Lindore dhe vendet e ish Bashkimit Sovjetik.

Co-Plan, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe Universiteti Polis janë tre partnerët që i bashkëngjiten kësaj

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të krijohet një platformë për ndarjen e informacionit mbi reformën e administratës publike dhe zhvillimin profesional të punonjësve të administratës vendore në fushat kryesore të qeverisjes vendore

Treguesit e arritjes

- Platforma e njohurive LOGIN është përgatitur dhe vënë në përdorim në faqen e internetit të Co-PLAN (www.co-plan.org)
- Nëntë module që mbulojnë aspektet kryesore të qeverisjes vendore dhe reformën në administratën publike janë pjesë e kësaj platforme
- 60 dokumente, raporte dhe informacione mbi legjislacionin janë hedhur në platformë dhe janë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit
- Dokumentet e vendosura në platformën LOGIN në Shqipëri numërojnë rreth 600 shkarkime në dy muajt e fundit
- Tre oficerë projekti nga Co-PLAN dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë janë trajnuar mbi sistemin e menaxhimit përmbajtësor të LOGIN

Objekti 2

Të krijohet një rrjet partnerësh për ndarjen e informacionit dhe eksperiencave lidhur me qeverisjen vendore dhe zhvillimin e kapaciteteve lokale

Treguesit e arritjes

- Një Marrëveshje Bashkëpunimi mbi pasurimin e platformës me materiale dhe përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta është nënshkruar ndërmjet Co-PLAN dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë

Objekti 3

Të promovohet dhe të marketohet LOGIN si një platformë njohurish mbi çështje të pushtetit vendor dhe të reformës në administratën publike

Treguesit e arritjes

- Përgatitja dhe botimi i një artikulli në Gazetën e Bashkive të Shqipërisë mbi bazën e të dhënave LOGIN, qëllimin dhe funksionalitetin e saj

iniciative rajonale. Së shpejti do të lançohet platforma e LOGIN, në faqet përkatëse të internetit të partnerëve, me shumë materiale që do i vijnë në ndihmë njësive të qeverisjes vendore si në shqip dhe në anglisht.

Platforma LOGIN do të mundësojë që punonjësit e administratës vendore, vendim-marrësit dhe të gjithë ata që punojnë në fushën e qeverisjes vendore dhe decentralizimit të kenë mundësi të shkëmbejnë informacion dhe praktika në të gjitha fushat. Brenda vitit do të grumbullohen më shumë se 350 materiale në fushën e qeverisjes vendore duke përfshirë:

- Legjislacionin, ndryshimet e fundit dhe mendime nga grupe të ndryshme interesi;
- Linke për adresa interneti të dobishme;
- Kalendar me mundësi trajnimi duke përfshirë module trajnimi online.
- Lajme, aktivitete dhe mendime nga ekspertë mbi progresin e decentralizimit në Shqipëri.
- Integrimi Evropian.
- Artikuj, shkëmbim eksperiencash dhe praktikave më të mira nga shtetet e Ballkanit Perëndimor.
- Informacion mbi mundësi fondesh dhe asistencë teknike për aspekte të ndryshme të qeverisjes vendore.

12 Asistencë teknike dhe trajnime për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në Njësitë e Qeverisjes Vendore

Periodha e Zbatimit: 1 Prill 2008-31 Dhjetor 2008

Donatori: EPTISA Servicios de Ingenieria

Fondi: 53,500 €

Zbatohet në: 25 Njësi të Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Qëllimi i projektit “Asistencë teknike dhe trajnime për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në Njësitë e Qeverisjes Vendore” është dhënia e asistencës për qeverisjen lokale dhe rajonale në përmirësimin dhe konsolidimin e modeleve standarde të administratës publike në fushën e licencimit. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet trajnimeve, workshop-eve dhe asistencës së drejtpërdrejtë në punë, fillimisht në tri njësi vendore pilot (Bashkia Shkodër, Këshilli i Qarkut Elbasan dhe Komuna Dajt) dhe më pas në 22 njësi të tjera të qeverisjes vendore. Pjesë e projektit ka qenë edhe hartimi i një numri të madh dokumentesh për çdo njësi të qeverisjes vendore si: draft-rregulloret për sektorin e Urbanistikës dhe Transportit, skicimi dhe organizimi i Qendrës së Pritjes dhe Informimit të komunitetit, hartimi dhe aplikimi i formularëve dhe rregullave standarde në secilin prej sektorëve të përfshirë në projekt; dokumente këto të dorëzuara pranë njësive vendore përkatëse.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të trajnohen stafet e tri njësive pilot në drejtim të zhvillimit të njohurive të nevojshme për zbatimin e planit të veprimit për licencimet

Treguesit e arritjes

- Tre *workshop*-e janë organizuar në secilën njësi pilot, në drejtim të eksplorimit të mundësive të secilës njësi për të aplikuar procedurat standarde në dhënien e lejeve dhe licencave
- Pesë trajnime në punë janë organizuar në secilën njësi pilot për të lehtësuar zbatimin e procedurave të licencimit në fushën e Transportit dhe Urbanistikës, mënyrës së qarkullimit të dokumentacionit, formularëve të aplikimit, miratimit dhe mosmiratimit
- Tri projekt-rregullore janë hartuar për sektorët e Urbanistikës dhe Transportit si edhe për Qendrën e Pritjes dhe Informacionit të secilës Njësi të Qeverisjes Vendore
- 11 ekspertë në Bashkinë Shkodër, 7 ekspertë në Komunën Dajt dhe 8 ekspertë në Këshillin e Qarkut Elbasan janë trajnuar gjatë fazës pilot

Objekti 2

Të trajnohen trajnerët për të siguruar zbatimin e planit të veprimit në 22 njësi vendore gjatë fazës së replikimit të projektit dhe asistimin e tyre në këto njësi

Treguesit e arritjes


- 1 trajnim i trajnerëve është organizuar për ekspertët të cilët do të asistojnë Njësitë e Qeverisjes Vendore
- 22 *workshop*-e janë organizuar për sektorët e Urbanistikës dhe Transportit të 22 Njësi të Qeverisjes Vendore të përfshira në fazën e replikimit në drejtim të përmirësimit të procedurave të licencimit, formularëve të aplikimit, mënyrës së lëvizjes së dokumentacionit, miratimit/mosmiratimit të aplikimeve etj.
- Tri projekt-rregullore janë hartuar për sektorët e Urbanistikës dhe Transportit si dhe për Qendrën e Pritjes dhe Informimit të secilës prej NjQV-ve të përfshira në fazën e replikimit
- 127 ekspertë janë trajnuar, prej të cilëve 65 ekspertë në Bashki, 53 ekspertë në Komuna dhe 9 ekspertë në Këshillat e Qarqeve të përfshira në fazën e replikimit

Objekti 3

Të sigurohet informacioni i nevojshëm për të përmirësuar Planin e Veprimit gjatë punës me ekspertët e NjQV që janë përfshirë në projekt

Treguesit e arritjes

- Sugjerimi për përfshirjen e sektorëve të tjerë si ai i të ardhurave, i kadastrës dhe i ndihmës ekonomike në procesin e standardizimit të procedurave
- Hartimi i 25 modeleve të Qendrës së Pritjes dhe Informimit, një për secilën njësi vendore të përfshirë në këtë projekt, dhe propozimi i përfshirjes së tyre në planin e veprimit



13 MO.S.T. Mobilitet i Qëndrueshëm në Tiranë

Periudha e Zbatimit: 11 Gusht 2007 -31 Dhjetor 2008

Donatori: Programi i Fqinjësisë Itali-Shqipëri, INTERREG/CARDS

Fondi: 80,000 €

Zbatohet në: Bashkia e Tiranës Bashkia e Barit

Qëllimi i projektit MO.S.T. (Mobilitet i Qëndrueshëm në Tiranë) konsiston në krijimin e një rrjeti të bazuar në ndarjen e eksperiencave dhe zgjidhjet novatore kërkimore mbi problemet e mobilitetit, adresuar specialistëve të Bashkisë së Tiranës dhe asaj të Barit. Projekti është zbatuar nga tre partnerë shqiptarë, Co-PLAN, Bashkia e Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, si dhe gjashtë partnerë italianë nga rajoni i Puljas në Itali. Co-PLAN është fokusuar në përgatitjen dhe organizimin e një trajnimi treditor mbi çështje të menaxhimit të mobilitetit (lëvizshmërisë) për specialistë shqiptarë të fushës së transportit, mjedisit dhe planifikimit urban. Gjithashtu, janë kryer dy studime pilot me qëllim përgatitjen e planeve të zhvendosjes për punonjësit dhe nxënësit e dy institucioneve të zgjedhura paraprakisht, Bashkisë së Tiranës dhe shkollës së mesme “Harry Fultz”. Studimet kishin si qëllim analizimin e kërkesës për lëvizje, të aksesueshmërisë si edhe të ofertës për transport për zhvendosjet ditore të punonjësve dhe studentëve të këtyre institucioneve. Përgatitja e raportit final si një ekspozim i punës dhe arritjeve të secilit partner të projektit ishte ndër përgjegjësitë kryesore të Co-PLAN. Seminari përfundimtar i organizuar në Tiranë nga Co-PLAN ofroi një mundësi të shkëlqyer për ndarjen e informacionit dhe ndihmoi në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe institucioneve të përfaqësuara në fushën e menaxhimit të mobilitetit.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të krijohet një rrjet partnerësh për ndarje eksperiencash dhe zgjidhje novatore kërkimore lidhur me çështje të mobilitetit

Treguesit
e arritjes

- 23 specialistë shqiptarë në fushat e transportit, mjedisit dhe planifikimit urban morën pjesë në një trajnim treditor mbi menaxhimin e mobilitetit, të ofruar me asistencën e pesë ekspertëve italianë
- Dy takime me specialistë të Co-PLAN dhe Bashkisë së Tiranës u organizuan me asistencën e ekspertëve italianë me qëllim përgatitjen e planeve të zhvendosjes për punonjësit dhe nxënësit e të dy institucioneve
- Një seminar përfundimtar me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve të projektit dhe palëve të interesuara u zhvillua në Tiranë, në Dhjetor 2008
- 400 Libra dore, në gjuhët shqip dhe italisht, u përgatitën dhe u shumëfishuan me qëllim pasqyrimin e aktiviteteve dhe rezultateve të arritura nga secili partner
- 700 fletëpalosje mbi konceptin e menaxhimit të mobilitetit dhe objektivat e projektit u formuluan, shumëfishuan dhe shpërndanë
- Një manifestim masiv me fëmijët u organizua me qëllim promovimin e formave alternative të lëvizjes, si lëvizjet në këmbë dhe ato me biçikletë
- 200 kapele dhe 200 bluza janë përdorur për qëllime të ndërgjegjësimit qytetar mbi mobilitetin e qëndrueshëm

Objekti 2

Të përmirësohen kapacitetet lokale dhe t'u ofrohet mbështetje institucionale specialistëve të Bashkisë së Tiranës në lidhje me lëvizjen e qëndrueshme

Treguesit
e arritjes

- Shtatë specialistë të sektorëve të transportit dhe çështjeve sociale të Bashkisë së Tiranës morën pjesë në trajnimin mbi menaxhimin e mobilitetit
- Tre specialistë të Departamentit të Transportit në Bashkinë e Tiranës morën pjesë në grupin e punës që punoi për hartimin e planeve të zhvendosjes shtëpi-punë dhe shtëpi-shkollë
- *Software*-i VISSIM mbi menaxhimin e mobilitetit u vu në përdorim pranë departamentit të transportit, Bashkia e Tiranës
- Tre drejtues departamentesh pranë Bashkisë së Tiranës u pajisën me trajnimin përkatës mbi përdorimin e *software*-it

Objekti 3

Të ofrohen zgjidhje novatore kërkimore lidhur me çështje të menaxhimit të mobilitetit

Treguesit
e arritjes

- Metodologjia për përgatitjen e planeve të zhvendosjes shtëpi-zyrë dhe shtëpi-shkollë u hartua nga grupi i punës
- Dy formate pyetësorësh gjysmë të strukturuar u përgatitën dhe u administruan në institucionet pilot
- Tri seanca diskutimesh u organizuan mbi rezultatet e studimeve, ofertën e transportit dhe analizën e aksesueshmërisë
- Dy plane finale të zhvendosjeve ditore të punonjësve dhe nxënësve nga institucionet përkatëse drejt banesave dhe anasjelltas u përgatitën me qëllim eksplorimin e trajektoreve më efikase dhe të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore



14 Vlerësimi bazë i projekteve të aprovuara në kuadër të “Programit Mbështetës për Fuqizimin e Qeverisjes Vendore në Qarkun e Dibrës, Shqipëri”

Periudha e Zbatimit: 1 Qershor 2008-31 Dhjetor 2008

Donatori: Organizata Holandeze për Zhvillim – SNV Shqipëri

Fondi: 26,890 €

Zbatohet në: Qarku Dibër

Ky studim bazë është zhvilluar në kuadër të “Programit Mbështetës për Fuqizimin e Qeverisjes Vendore në Qarkun e Dibrës, Shqipëri” zbatuar nga SNV Peshkopi dhe Qarku i Dibrës. Ky program vepron nëpërmjet dy komponentëve kryesorë, njëri prej të cilëve mbështet forcimin e kapaciteteve të pushtetit vendor në Qarkun e Dibrës ndërsa tjetri vepron nëpërmjet një fondi të besuar të përdorur për investime të kërkuara nga vetë njësitë e qeverisjes vendore në këtë Qark. Në këtë kuadër, SNV është e interesuar të vlerësojë ndikimin e projekteve të aprovuara brenda këtij programi. Kështu, Co-PLAN ka ndërmarrë këtë studim bazë për të vlerësuar ndikimin e secilit prej 24 projekteve të aprovuara gjatë vitit 2008 duke siguruar edhe tregues të matshëm për secilin prej projekteve si edhe një listë me tregues tematikë.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objektivi 1

Të përcaktohet një grup treguesish për të matur ndikimin e secilit projekt investimi

Treguesit e arritjes

- 24 pyetësorë për familjet u hartuan me qëllim matjen e perceptimit të përfituesve mbi situatën para dhe pas realizimit të investimit
- 5 formate udhëzuese për diskutimet në grupet e fokusit u përgatitën me qëllim matjen e perceptimeve të banorëve mbi situatën para dhe pas investimit
- Një numër i madh treguesish u hartuan dhe më pas u miratuan nga donatori dhe Qarku i Dibrës

Objektivi 2

Të përcaktohen tregues tematikë për secilin grup investimesh

Treguesit e arritjes

- 5 grupe tematike investimesh u identifikuan bazuar në investimet e vlerësuara gjatë vitit 2008
- 5 grupe treguesish u hartuan përkatësisht për të pesë grupet e investimeve

Objektivi 3

Të përcaktohen treguesit bazë për secilin projekt me qëllim matjen e ndikimit të investimeve të realizuara

Treguesit e arritjes

- Një raport i shkruar është përgatitur për secilin nga të 24 investimet e realizuara në Qarkun e Dibrës i cili përfshin një sërë treguesish bazë për secilin projekt.



15 Vëzhgimi Social-Ekonomik dhe Demografik në Bashkinë e Sukthit

Periodha e Zbatimit: 1 Shtator 2008 – 15 Nëntor 2008

Donatori: Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Fondi: 7,930 €

Zbatohet në: Bashkia Sukth

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, në bashkëpunim me Rrjetin e Shoqatave të Autoriteteve Vendore për Evropën Juglindore dhe me mbështetjen e GTZ-Agencia Gjermane për Zhvillimin Ekonomik, ka nisur zbatimin e projektit pilot “Integrimi urban i zonave informale” në Bashkinë e Sukthit, Shqipëri. Qëllimi madhor i këtij projekti është të mbështesë Bashkinë e Sukthit në përpjekjet e saj për të integruar një numër të madh ndërtimesh informale në strukturën urbane ekzistuese, të përmirësojë procesin e planifikimit urban dhe të hartojë një dokument strategjik mbi zhvillimin urban si edhe Planin Urban.

Vëzhgimi social-ekonomik dhe demografik është pjesë e këtij projekti dhe synon të prodhojë të dhëna dhe informacion social, ekonomik dhe demografik të besueshëm. Këto të dhëna do të përdoren gjatë përgatitjes së planit të zhvillimit urban të Bashkisë së Sukthit, një instrument i cili do ta ndihmojë këtë Bashki në integrimin e ndërtimeve informale në strukturat ekzistuese urbane.

OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objektivi 1

Të vlerësojë strukturën ekonomike dhe sociale në Sukth duke dalluar ndërmjet banorëve formalë dhe atyre informalë si dhe të vlerësojë potencialin e banorëve informalë për t’u integruar në strukturën urbane

Treguesit e arritjes

- v Dy pyetësorë të strukturuar u përdorën për të mbledhur të dhëna nga familje, të migruara apo jo, që banojnë në Sukth në ndërtesa formale dhe informale
- v Një raport përfundimtar u hartua, i cili përmbante të dhëna dhe informacion social, ekonomik dhe demografik mbi familjet dhe banorët formalë dhe ata informalë
- v Një sërë treguesish u prodhuan, të cilët shërbejnë për të krahasuar strukturat formale me ato informale në aspektet sociale, ekonomike dhe demografike
- v Një sërë treguesish janë hartuar në lidhje me aksesin në infrastrukturë dhe shërbime si edhe në zotërimin dhe përdorimin e një sërë asetesh nga ana e banorëve informalë

Objektivi 2

Të vlerësojë pritshmërinë e banorëve formalë dhe atyre informalë të cilët banojnë në Bashkinë e Sukthit

Treguesit e arritjes

- v Është hartuar një numër i madh treguesish të cilët shërbejnë për të matur kënaqshmërinë e banorëve të Sukthit si edhe pritshmërinë e tyre në lidhje me ofrimin e shërbimeve, nivelin ekonomik, nivelin e jetesës etj. Tregues të veçantë u paraqitën për familjet formale përkundrejt atyre informale



16 Planet e Investimeve Kapitale: Një element i rëndësishëm i menaxhimit financiar bashkiak në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Periudha e Zbatimit: Dhjetor 2008

Donatori: NUFFIC – Organizata Holandeze për bashkëpunimin Ndërkombëtar në Arsimin e Lartë

Fondi: 70,000 €

Zbatohet në: Kurs i zhvilluar në Tiranë në bashkëpunim me IHS Rotterdam dhe IHS Rumani

Objekti afatgjatë dhe i përgjithshëm i kursit ishte të ndihmojë qytetet në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të hartojnë Plane më të efektshme të Investimeve Kapitale, të aksesojnë burime alternative të financimit, të rrisin kapacitetet vendore dhe, për rrjedhojë, të përmirësojnë kapacitetet për sigurimin e shërbimeve, për garantimin e zhvillimit ekonomik si edhe për t'i bërë qytetet e tyre më konkurruese.

Për këtë arsye, gjatë kursit, pjesëmarrësit u inkurajuan të: (i) prezantonin dhe diskutonin raste të projekteve kapitale nga qytetet e tyre si edhe arritjet dhe vështirësitë përkatëse; (ii) identifikonin dhe analizonin, brenda kontekstit të menaxhimit financiar bashkiak, çështjet kyç me të cilat përballemi gjatë hartimit të një plani të zbatueshëm investimesh kapitale; dhe (iii) analizonin përshtatshmërinë e rasteve studimore ndërkombëtare të prezantuara gjatë kursit për qytetet e tyre. Kursi konsistoi në një kombinim të leksioneve nga stafi i IHS dhe Co-PLAN dhe nga lektorë të ftuar, prezantime nga vetë pjesëmarrësit, ekskursione, punë në grup dhe prezantime përfundimtare në grup, ku pjesëmarrësit nga 5 vende të ndryshme të rajonit patën mundësi të shkëmbenin eksperiencën të vlefshme me njëri-tjetrin.



OBJEKTIVAT DHE TREGUESIT E ARRITJES

Objekti 1

Të prezantojë dhe diskutojë rastet e projekteve kapitale nga qytete të Evropës Qendrore dhe Lindore së bashku me arritjet dhe vështirësitë e këtyre projekteve

Treguesit e arritjes

- 12 raste të planeve të investimeve kapitale nga Rumania, Lituania, Serbia, Armenia dhe Shqipëria u prezantuan dhe u diskutuan ndërmjet pjesëmarrësve
- Projektet kapitale të diskutuara gjatë kursit u përqendruan në ndërtimin e venddepozitimeve të mbeturinave të tipit landfill, menaxhimin e mbetjeve urbane dhe infrastrukturave kryesore të qyteteve (ura dhe autostrada), strehimin social, rigjenerimin urban etj.

Objekti 2

Të identifikojë dhe analizojë, brenda kontekstit të menaxhimit financiar bashkiak, çështjet kyç të cilat hasen gjatë hartimit të një plani të zbatueshëm investimesh kapitale

Treguesit e arritjes

- 6 sesione të kursit u përqendruan në identifikimin dhe analizimin e çështjeve të lidhura me planifikimin e planeve të zbatueshme të investimeve kapitale si: burimet alternative të financimit për projekte kapitale, pjesëmarrja qytetare në planifikimin e planeve të investimeve kapitale, koordinimi i fondeve për projekte kapitale, monitorimi i planit të investimeve kapitale etj.
- Një lektor i ftuar trajtoi çështjet me të cilat përballlet hartimi i planit të investimeve kapitale në Shqipëri
- 2 vizita në terren u organizuan në Bashkitë e Tiranës dhe Durrësit me qëllim diskutimin e planifikimit të investimeve kapitale në nivel vendor
- Një prezantim dhe një takim me Universitetin Polis u organizua me qëllim diskutimin e projekteve të investimeve kapitale dhe planifikimit në tërësi në Shqipëri dhe veçanërisht në Tiranë

Objekti 3

Të analizojë përshtatshmërinë e rasteve studimore ndërkombëtare të prezantuara gjatë kursit për qytetet përkatëse

Treguesit e arritjes

- 7 raste studimore nga Rumania, Polonia, Shqipëria, Serbia etj. u prezantuan dhe u diskutuan në tre sesione të ndryshme të kursit
- Të 15 pjesëmarrësit në këtë kurs diskutuan mbi përshtatshmërinë e rasteve studimore të paraqitura për vendet e tyre

Objekti 4

Të themelojë një rrjet profesionistësh nga shtete të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore për çështje të planifikimit të investimeve kapitale

Treguesit e arritjes

- 15 pjesëmarrës nga Rumania, Armenia, Lituania, Serbia dhe Shqipëria kanë marrë pjesë në këtë kurs
- Numra kontakti, e-maile dhe adresa u shkëmbyen ndërmjet pjesëmarrësve dhe një rrjet profesionistësh nga 5 vende u themelua
- 2 ekspertë të Co-PLAN dhe IHS Rotterdam janë në proces shkrimi të një artikulli të përbashkët mbi menaxhimin financiar bashkiak, në vijim të kontakteve dhe eksperiencave të ofruara gjatë këtij kursi

